

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6042
E shtunë, 20 qershor 2020
çmimi 0.40 €

53 milionë euro për sektorin e bujqësisë



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", VALBON KRASNIQI | FAQE 4-5

Rritja e rasteve me Covid-19, shqetësuese

Për infektologun Valbon Krasniqi rritja e numrit të infektuarve me Covid-19 është shumë shqetësuese. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se rritja e përnjëhershme e rasteve mund të shkaktojë sfida serioze të menaxhimit të pandemisë. Krasniqi ka treguar se nëse fluksi i të infektuarve vazhdon të rritet, institucionet shëndetësore do të përballen me një presion të madh. Ai i ka ftuar qytetarët të jenë të kujdesshëm, të bartin maska dhe të mbajnë distancë fizike



OPINION

ÇFARË E BËRI DHE ÇFARË E BËN EDHE SOT ADEM JASHARIN KREJT TË VEÇANTË NË HISTORINË E KOMBIT TONË? F. 11

Bedri ISLAMI



AKTUALE

UNICEF-I BËN THIRRJE PËR RESPEKTIMIN E MASAVE PARANDALUESE TË COVID-19 F. 5

KRYEMINISTRI TAKON REKTORËT E UNIVERSITETEVE PUBLIKE, DISKUTON PËR ZHVILLIMET NË ARSIMIN UNIVERSITAR F. 7

EKONOMI

PENSIONISTËT S'KANË OBLIGIM TË LAJMËROHEN NË ZYRAT PËR PENSIONE F. 8

NGA 1 KORRIKU KOSOVA DHE SHQIPËRIA ME PLATFORMË TË PËRBASHKËT TURISTIKE F. 8

SPORT

MINISTRJA DUMOSHI MORI PJESË NË LANSIMIN E ORGANIZATËS KOSOVA JEWISH ORGANIZATION F. 2

SPORT

FETAHU: GJAKOVA, ISTOGU DHE FERIZAJ, TË GATSHËM PËR ZHVILLIM DHE AVANCIMIN E BASKETBOLLIT F. 14



MAVRAJ PËR TAKIMIN E 27 QERSHORIT NË UASHINGTON: TË GJITHA PALËT NË KOSOVË TË JENË TË BASHKUARA

Profesori universitar, publicisti dhe botuesi Muhamet Mavraj, ka folur të premtën për takimin që është paralajmëruar se do të mba-

het më 27 qershor në Uashington ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Mavraj ka thënë se iniciativa e Shteteve të Bashkuara të Amerikës,

për ta rifilluar këtë proces, është serioze. Ai ka bërë thirrje për bashkim të spektrit politik për këtë proces | FAQE 3

QUNI NË SHQIPËRI: USHTRIA SHQIPTARE, ALEATE E NATYRSHME E FSK-SË NË RRUGËN DREJT NATO-S



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Ngërçi në Këshillin Politik, Meta: Nëse dera e Evropës mbyllet, dihet kush është përgjegjës

TIRANË, 19 QERSHOR - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka komentuar ngërçin e krijuar në Këshillin Politik për Reformën Zgjedhore në lidhje me reformatimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Meta në një konferencë për media ka kërkuar nga palët që t'i qëndrojnë marrëveshjes për ta çuar vendin sa më shpejt drejt zgjedhjeve të reja. Sipas tij, tashmë është e qartë se kush janë përgjegjësit nëse dyert e

Evropës mbyllen sërish. "Uroj që palët t'i qëndrojnë marrëveshjes që kanë nënshkruar, e cila mund të lerë mjaft për të dëshiruar në përmbajtjen e saj, por ne e dimë se jemi në një situatë kritike të një mosbesimi të thellë dhe të problemeve serioze të legjitimitetit të institucioneve. Është koha për të kuptuar seriozisht të gjitha këto shqetësime që vijnë nga partnerët evropianë të cilët kanë bërë përpjekjet më të

mëdha për ta lënë derën hapur për Shqipërinë, por në rast se dera do të mbyllet, të gjithë shqiptarët do ta kenë të qartë se kush e ka përgjegjësinë", ka thënë Meta, duke shpresuar që të ketë reflektim të shpejtë, në mënyrë që të ecet drejt zgjedhjeve të lira dhe të ndershme. "Është e sigurt që zgjedhjet e ardhshme do të jenë nën një monitorim tepër të ashpër nga faktori ndërkombëtar", ka thënë Meta.



Quni në Shqipëri: Ushtria shqiptare, aleate e natyrshme e FSK-së në rrugën drejt NATO-s

EPOKA ERE

Qendresa RAMA

TIRANË, 19 QERSHOR - Me ftesë të homologes së tij, Olta Xhaçka, ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, ka qëndruar për vizitë zyrtare në Shqipëri, ku është pritur me ceremoni të lartë ushtarake. Në takim dypalësh, Xhaçka e ka uruar Qunin për detyrën e re, duke thënë se me përvojën si udhëheqës ushtarak i karrierës dhe me përvojën politike përfaqëson dhe do t'i përfaqësojë denjësisht aspiratat e Kosovës për integrimin euroatlantik dhe synimin kombëtar për zhvillimin e forcave ushtarake bashkëkohore. "Integrimi euroatlantik është synim i natyrshëm i Kosovës, krahas synimit të të gjitha vendeve të Ballkanit. Në emër të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë jua garantojmë gatishmërinë tonë për ta shtuar bashkëpunimin mes dy vendeve dhe, mbi të gjitha, për ta ndarë me Ministrinë e Mbrojtjes, përvojën tonë lidhur me anëtarësimin në NATO", ka thënë Xhaçka.

Ndërsa ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, ka nënvizuar se për Kosovën, krahas partneritetit me miqtë tanë të

përhershëm si ShBA-në, Mbretërinë e Bashkuar, Gjermaninë, Turqinë etj., Shqipëria është aleatja e natyrshme në rrugëtimin drejt anëtarësimin të vendit tonë në organizata rajonale të sigurisë, programin për partneritetin për paqe dhe për t'u finalizuar me integrimin në NATO. "Objektivi kryesor i Ministrisë së Mbrojtjes, pas kalimit në misionin e ri të FSK-së, është përmbushja e detyrave të përcaktuara në Planin e Tranzicionit të FSK-së në forcë ushtarake, e cila do të jetë në shërbim të të gjithë qytetarëve të saj pa dallime etnike, kulturore, religjioni etj. Mbështetja vëllazërore e deritashme dhe në të ardhmen e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si në rrafshin politik dhe në atë ushtarak, është shumë e rëndësishme për operacionalitetin e FSK-së në përmbushjen e misionit dhe detyrave kushtetuese dhe ligjore, me theks për ofrimin e kontributit në operacione shumëkombëshe në ruajtje të paqes, sigurisë dhe stabilitetit rajonal e më gjerë", është shprehur Quni. Në vazhdim të diskutimeve, të dy ministrat kanë vlerësuar se pandemia



Covid-19 është menaxhuar me sukses nga ana e dy ministrave dhe forcave në mbështetje ushtarake të autoriteteve civile. Pas takimit në mes të dy delegacioneve, ministrat Quni dhe Xhaçka kanë dalë në një konferencë për medie, ku kanë theksuar se në takimin e së premtes kishin për qëllim thellimin e mëtejme të bashkëpunimit bilateral dhe rritjen e mbështetjes në të gjitha fushat, respektivisht për realizimin e Planit të

Bashkëpunimit Bilateral në mes dy ministrave. Quni ka theksuar se trajtimi i temave me interes të përbashkët nga fusha e sigurisë dhe mbrojtjes është shumë i gjerë, duke e ftuar ministren Xhaçka për vizitë të ndërsjellë në Kosovë. Pas takimit në Ministrinë e Mbrojtjes, delegacioni, i shoqëruar nga zëvendësministri i Mbrojtjes, Petro Koçi, ka vizituar Muzeun Historik të Forcave të Armatosura. Gjatë vizitës delegacioni i ministrit Quni

përbëhej nga komandantja e KDS-së, gjeneralbrigade Irfete Spahiu, ambasadori i Republikës së Kosovës në Tiranë, Nait Hasani, atasheu ushtarak kolonel Bashkim Shillova, drejtori i Departamentit për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Integritet Euroatlantik, kolonel Hasan Hoxha, zyrtarja e lartë, Martina Dedaj-Kçira si dhe këshilltarët, Feriz Trezhnjeva e kolonel Hamdi Pollomi.

Ministrja Dumoshi mori pjesë në lansimin e organizatës Kosova Jewish Organization

PRISHTINË, 19 QERSHOR (ER) - Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, ka marrë pjesë në ceremoninë e lansimit të organizatës hebraike-kosovare Kosova Jewish Organization, aktivitet i organizuar bashkë me British Academy. Qëllimi i kësaj organizate është rritja e shkëm-

bimeve kulturore dhe edukative midis Izraelit dhe Kosovës dhe për t'i afruar dy popujt me njëri-tjetrin. Kjo organizatë është rezultat i një grupi vullnetarësh që kanë avokuar edhe vite me herët në të njëjtat fusha. Ministrja Dumoshi uroi themeluesit e kësaj organizate

për nisjen e aktiviteteve dhe realizimin e qëllimeve të mira të saj në vendin tonë. Organizatat të cilat kanë për synim rritjen e shkëmbimeve kulturore dhe sjelljen e përvojave të mira në Republikën e Kosovës janë të mirëseardhura dhe ministria i mirëkupton dhe i përkrah, ka vlerësuar ministrja.



Mavraj për takimin e 27 qershorit në Uashington: Të gjitha palët në Kosovë të jenë të bashkuara

Prishtinë, 19 qershor - Profesi universitar, publicisti dhe botuesi Muhamet Mavraj, në "Studion e hapur" në Radio Televizionin e Kosovës (RTK) në kanal 3, ka folur të premten për takimin që është paralajmëruar se do të mbahet më 27 qershor në Uashington ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Mavraj ka thënë se iniciativa e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për ta rifilluar këtë proces, është serioze. Ai ka bërë thirrje për bashkim të spektrit politik për këtë proces. "Tash, përtej moralizimeve të tepruara për çështjen e unitetit, jo vetëm në këtë rast, por edhe për rastet e tjera, është mirë që të gjitha palët në Kosovë ta kenë emëruesin e përbashkët, të kenë një kornizë në të cilën gjithmonë janë të përafërta ose unike. Pra, edhe më 27 qershor. Megjithatë, nuk është tragjike, se ende nuk jemi në atë çastin kur kërkohet doemos një unitet nominal. Kjo është vetëm një pjesë e dialogut. Pjesa tjetër e dialogut, kryesorja, mbetet për muajt e ardhshëm, sidomos nga korriku e tutje", ka shprehur mendimin Mavraj.

Mavraj, ndër të tjera, ka folur edhe për mospjesëmarrjen e Lëvizjes Vetëvendosje (LV-së) dhe të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK-së) në takimin e thirrur nga kryeministri Avdullah Hoti, në të cilin temë e diskutimit ishte përgatitja për takimin në Shtëpinë e Bardhë. Ai ka thënë se në këtë fazë nuk është tragjike mosprania e LV-së dhe e PDK-së në takimin me Hotin. "Në këtë fazë nuk është tragjike, po them edhe një herë. Partitë qeveritare shqiptare janë



unike në këtë plan dhe është një minimum i domosdoshëm i garantimit të procesit për ecjen përpara. Dy partitë opozitare, LV-ja dhe PDK-ja, të cilat për arsyt e veta i kanë bishtuar këtij takimi, në të njëjtën kohë ia mbyllën vetes pak a shumë rrugën që të adresojnë kritika retorike për sa i përket lirimit të qeverisë ndaj tyre. PDK-ja e shtroi vërejtjen te mënyra e ftesës, kurse LV-ja për qëndrimet që dihen historikisht dhe për shkak të këtyre situatave që kanë përmbysur realitetin politik në Kosovë e që nuk është pritur ndryshe. Por, nuk mendoj se në një çast crucial ky dialog nuk do të jetë me një mbështetje më të

madhe nëse gjithçka shkon në rregull dhe jo në çfarëdo terminologjie që i nxitë reagimin, pakënaqësinë, ndoshta edhe ndërprerjen e dialogut", ka thënë Mavraj, përcjell "Epoka e re".

Në pyetjen se a do të jetë temë ndryshimi i kufirit Kosovë - Serbi më 27 qershor në Uashington, duke iu referuar akuzave të Albin Kurtit drejtuar Grenellit, se po bën nguti në procesin e dialogut, të cilin e ka akuzuar edhe për ndryshim të kufirit, Mavraj ka pohuar se tema e ndryshimit të kufirit është temë e paqenë sepse, sipas tij, nuk ka asnjë dokument që dëshmon një gjë të tillë. "Janë tema të paqena dhe nuk

ekzistojnë tema të tilla. Nuk ka asnjë dokumentacion. Ka pasur vetëm dyshime. Jo vetëm nga Albini, por edhe nga njerëz të tjerë të skenës publike. Në fakt, reagimet e Albinit kanë qenë të tjera fare dhe kanë të bëjnë kryesisht me natyrën dhe me stilin e negociatave dhe të biseduarit, sigurisht edhe me konfliktin e tij me Hashim Thaçin, i cili në njëfarë mënyre tash ka marrë udhë të re. Tash gjërat janë krejtësisht ndryshe. Thaçi shkon në Uashington bashkë me kryeministrin, ndërsa ish-kryeministri ngelet në opozicion. Mendoj se mund të luajë rol të rëndësishëm edhe në këtë

pozicion çfarë është. As ai dhe askush tjetër, as PDK-ja, nuk mund t'i kundërvihet me çdo kusht këtij procesi i cili, në fakt, duke u vonuar, nuk i konvenon Kosovës. Humbja e Kosovës nuk është në favorin tonë. Këtë duhet ta kenë parasysh të gjithë faktorët, edhe këta që janë në qeveri, edhe opozita parlamentare, po ashtu edhe opozita jashtëparlamentare, përfshirë këtu shoqërinë civile dhe opinionin publik", ka deklaruar Mavraj.

Ai ka bërë me dije se në takimin e 27 qershorit përfaqësuesit legjitimë të shtetit të Kosovës duhet të jenë të kujdesshëm dhe të jenë më dinjitozë.

Pompeo, Hotit: Vazhdojmë ta mbështesim Kosovën në dialogun me Serbinë

Prishtinë, 19 qershor (ER) - Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, ka mirëpritur vendimin e Qeverisë së Kosovës për heqjen e pengesave për bisedimet me Serbinë dhe ka porositur që Kosova të jetë e gatshme "t'i rifillojë negociatat me Serbinë sa më parë që është e mundshme". Kështu thuhet në telegramin e urimit që Sekretari Pompeo i ka dërguar kryeministrin të Kosovës, Avdullah Hoti, me rastin e zgjedhjes së këtij të fundit në këtë pozitë. "Ne vazhdojmë ta mbështesim Kosovën në avancimin e procesit të normalizimit të plotë të

marrëdhënieve me Serbinë, të përqendruara në njohjen e ndërsjellë, që është esenciale për Kosovën sa i përket integritet global dhe arritjes së potencialit të saj të plotë. E kemi mirëpritur vendimin e qeverisë suaj për heqjen e të gjitha masave të reciprocitetit mbi mallrat serbe, që shënoi një hap vital për rinisjen e procesit të dialogut. Kosova duhet të jetë e gatshme t'i rifillojë negociatat me Serbinë sa më parë që është e mundshme", thuhet në telegramin që Pompeo i ka dërguar Hotit.

Delegacionet nga Kosova dhe Serbia do të takohen më 27



qershor në Shtëpinë e Bardhë. Ky takim është thirrur nga i dërguari i Shtëpisë së Bardhë për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell. Dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ka nisur më 2011 me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian. Në fund të vitit 2018 ky proces u ndërpre për shkak se Qeveria e Kosovës kishte vendosur një taksë ndaj produkteve serbe. Taksë prej 100 përqindësh më pas u zëvendësua me masat e reciprocitetit, të cilat më 6 qershor i shfuqizoi qeveria e Avdullah Hotit për, siç u tha, t'i dhënë mundësi rinisjes së dialogut.

FLET PËR “EPOKËN E RE”, VALBON KRASNIQI

RRITJA E RASTEVE ME C



Për infektologun Valbon Krasniqi rritja e numrit të të infektuarve me Covid-19 është shumë shqetësuese. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, ai ka thënë se rritja e përnjëhershme e rasteve mund të shkaktojë sfida serioze të menaxhimit të pandemisë. Krasniqi ka treguar se nëse fluksi i të infektuarve vazhdon të rritet, institucionet shëndetësore do të përballen me një presion të madh. Ai i ka ftuar qytetarët të jenë të kujdesshëm, të bartin maska dhe të mbajnë distancë fizike

veçantë në ambientet e mbyllura si dhe ta ruajnë distancën fizike”, është shprehur ai. Sipas tij, shqetësuese në këtë fazë është qarkullimi dhe mosrespektimi i masave nga ata që janë konfirmuar me Covid-19 pozitiv dhe që janë asimptomatikë.

Krasniqi ka thënë se qarkullimi i tyre duhet të monitorohet nga institucionet përkatëse. Ai ka treguar se nëse fluksi i të infektuarve vazhdon të rritet, institucionet shtetërore do të përballen me një presion të madh. “Nëse vazhdon të kemi numër të madh të rasteve dhe rrjedhimisht të atyre që kanë nevojë për trajtim spitalor, shumë shpejt institucionet tona do të gjenden përballë një presioni të jashtëzakonshëm për t’i trajtuar këto raste. Tanimë ne si QKUK dhe ShSKUK kemi aktivizuar planin që kemi pasur në fillim”, ka deklaruar Krasniqi.

“Epoka e re”: Ditët e fundit

është shtuar numri i të infektuarve me Covid-19. Sa po rëndohet situata e përgjithshme epidemiologjike në vend me shtimin e rasteve?

Krasniqi: Është shumë shqetësuese rritja kaq e madhe e numrit të rasteve të reja me Covid-19 për një periudhë të shkurtër kohore. Kjo mund të na shkaktojë sfida serioze për sa i përket menaxhimit të pandemisë. Jemi të shqetësuar sidomos për aspektin klinik të pandemisë, sepse numri i të shtrirëve është rritur në mënyrë të shpejtë ditët e fundit, e që pritet të kemi numër të madh të rasteve të reja të të infektuarve.

“Epoka e re”: Sa janë institucionet shëndetësore në gjendje ta përballojnë këtë fluks të të infektuarve?

Krasniqi: Që në fillim të pandemisë kemi potencuar se një e pesta e të infektuarve kanë kërkuar trajtim spitalor. Nëse i krahasojmë vetëm dy

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Infektologu Valbon Krasniqi ka bërë me dije se rritja e rasteve me Covid-19 do të mund të shkaktojë sfida serioze në menaxhimin e pandemisë. Ai ka thënë se rritja e menjëhershme e rasteve të reja me koronavirus është shumë shqetësuese.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, Krasniqi u ka bërë thirrje qytetarëve të Kosovës që të jenë të

kujdesshëm në daljet e tyre dhe të bartin maska. “Është shumë shqetësuese rritja kaq e madhe e numrit të rasteve të reja me Covid-19 për një periudhë të shkurtër kohore. Kjo mund të na shkaktojë sfida serioze për sa i përket menaxhimit të pandemisë. Jemi të shqetësuar sidomos për aspektin klinik të pandemisë, sepse numri i të shtrirëve është rritur në mënyrë të shpejtë ditët e fundit, e që pritet të kemi numër të madh të rasteve pas rasteve të reja të të infektuarve”, ka thënë Krasniqi.

Ai ka bërë me dije se institucionet përgjegjëse janë në përcjellje të situatës dhe përgjigjja duhet të jetë sipas nevojës. “Unë besoj se Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik janë duke e përcjell me vëmendje situatën epidemiologjike, por ne vazhdojmë t’u bëjmë thirrje qytetarëve që të vazhdojnë t’i respektojnë masat për parandalimin e përhapjes së këtij virusi. Pra, ata duhet të jenë të kujdesshëm dhe të mbajnë maska, në mënyrë të

COVID-19, SHQETËSUERE



javët e fundit, nuk është se kemi përqindje kaq të lartë të të shtrirëve në spital. Pra, kemi rreth 10 për qind të të gjithë të infektuarve.

Mirëpo shqetësimi ynë është se rritja ka ardhur e përnjëhershme për një periudhë të shkurtër kohore. Kjo i vë në pozicion sfidues dhe presion të madh institucionet shëndetësore për ta përballuar fluksin e pacientëve të cilët do të kenë nevojë për një trajtim spitalor. Mund të bëj një krahasim, ne për tre muaj e gjysmë kemi pasur rreth 200 pacientë të shtrirë në Klinikën Infektive, ndërsa vetëm brenda dy jave i kemi mbi 60 pacientë të shtirë të konfirmua me Covid-19.

“Epoka e re”: *Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës vazhdimisht ka bërë thirrje për kujdes të shtuar pas lehtësimit të masave, mirëpo këto këshilla nuk janë respektuar nga qytetarët. Si institucione shëndetësore, keni menduar për ndërmarrjen e ndonjë mase më radikale në këtë drejtim?*

Krasniqi: Besoj se Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik janë duke e përcjellë me vëmendje situatën epidemiologjike. Por ne vazhdojmë t’u bëjmë thirrje

qytetarëve që të vazhdojnë t’i respektojnë masat për parandalimin e përhapjes së këtij virusi. Pra, ata duhet të jenë të kujdesshëm dhe të mbajnë maska, në mënyrë të veçantë në ambientet e mbyllura si dhe ta ruajnë distancën fizike. Një tjetër shqetësim që kemi ne si klinistë është se tani edhe pacientët që janë të konfirmuar pozitivë me Covid-19, që janë asimptomatikë dhe nuk kanë nevojë për trajtim spitalor, nuk janë duke i respektuar masat pasi janë duke qarkulluar. Ne kemi pasur raste në kliniken tonë që familjarët tentojnë t’i vizitojnë të infektuarit që janë të shtrirë këtu. Kjo është e patolerueshme. U bëj thirrjeve institucioneve që ta monitorojnë edhe lëvizjen e personave me Covid-19 pozitiv dhe të kontakteve të tyre, sepse këta bartin rrezik serioz për përhapje të infeksionit.

“Epoka e re”: *Nëse fluksi i të infektuarve vazhdon të jetë i lartë edhe në ditët në vazhdim, a mund të kthehemi në kushte të izolimit siç kemi qenë në fillim të pandemisë?*

Krasniqi: Unë ju flas për aspektin klinik. Nëse vazhdon të kemi numër të madh të rasteve dhe rrjedhimisht të atyre që kanë nevojë për

trajtim spitalor, shumë shpejt institucionet tona do të gjenden përballë një presioni të jashtëzakonshëm për t’i trajtuar këto raste. Tanimë ne si QKUK dhe ShSKUK kemi aktivizuar planin që kemi pasur në fillim, kemi liruar hapësirat e Klinikës së Pulmologjisë dhe të Dermatologjisë për t’i rritur kapacitete tona dhe për t’u përballur me këtë situatë. Në total për momentin kemi 250 shtretër dhe jemi duke përgatitur një hapësirë për kujdes intensiv për pacientët që do të kenë nevojë për kujdesje klinike.

“Epoka e re”: *Po në aspektin e resurseve humane, sa ka kapacitet Kosova ta përballojë rritjen e fluksit të të infektuarve?*

Krasniqi: Sa iu përket kapaciteteve të shtretërve, ajo nuk do të paraqesë ndonjë problem të madh sepse ata do të akomodoheshin në klinika të tjera. Problem do të jenë resurset humane, specialistët e fushave përkatëse që do t’i trajtojnë këto raste. Ju e dini numrin e infektologëve në Klinikën Infektive, që jemi 21, përafërsisht kaq janë edhe nëpër klinika regjionale. Prandaj, do të jetë një sfidë e jashtëzakonshme për t’i trajtuar rastet e reja.

UNICEF-i bën thirrje për respektimin e masave parandaluese të Covid-19

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Gjersa numri i rasteve me Covid-19 vazhdon të rritet, UNICEF-i kërkon që të kujdeseni për shëndetin dhe mirëqenien tuaj dhe t’i mbronit të tjerët. Përderisa shpejtësia dhe shkalla e shpërthimit nga infektimi po paraqesin sfida të panumërta, UNICEF-i bën thirrje që të vazhdohet ndërmarrja e tri masave paraprake të thjeshta për t’i zvogëluar shanset për infektim ose përhapje të Covid-19: Mbani maskë në hapësirat publike; Mbani të paktën 1.5 metër distancë me të tjerët; Lani rregullisht duart tuaja me sapun dhe ujë. “Mbrotjtja e shëndetit të fëmijëve dhe

komuniteteve mbetet prioritet kryesor për UNICEF-in. Ne jemi në partneritet me institucionet, shoqërinë civile, mediat, prindërit dhe të rinjtë në mënyrë që të reagojmë dhe të rimarrim veten nga efektet e Covid-19. Është arritur progres i konsiderueshëm, por duhet të bëhet shumë më tepër për krijimin e një normaliteti të ri. Unë vetë i praktikoj dhe u bëj thirrje të gjithëve të praktikojnë tre hapa të thjeshtë ‘maskë, distancë, higjienë’ për ta mbrojtur njëri-tjetrin”, ka thënë Murat Sahin, shef i Zyrës së UNICEF-it të Kosovës.

Që nga fillimi i shpërthimit, UNICEF-i ka siguruar 7.1 tonë të pajisjeve mbrojtëse personale (PMP) për Ministrinë e Shëndetësisë, ku 10 për qind e tyre janë shpërndarë në

institucionet shëndetësore të komunitetit serb. 20 000 pako të higjienës familjare dhe pajisje shtesë për fëmijët u janë shpërndarë përmes Kryqit të Kuq të Kosovës familjeve në nevojë me mbështetjen financiare të USAID-it në Kosovë dhe Qeverisë së Luksemburgut.

UNICEF-i do të vazhdojë të sigurojë asistencë teknike, ofrim të furnizimeve esenciale, mbështetje efektive të komunikimit për ta siguruar mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe familjeve të tyre. Gjatë muajve të ardhshëm, në konsultim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe OBSH-në, UNICEF-i do të sjellë 37.5 tonë shtesë pajisje mbrojtëse personale (PMP) për punonjësit shëndetësorë të vijës së parë.



Këto furnizime esenciale janë vënë në dispozicion përmes mbështetjes bujare të Qeverisë së Luksemburgut me 19 tonë (2 476 900 njësi PMP), Ambasadës së Japonisë në Kosovë me 9.5 tonë (993 750 PMP) dhe Fondi i Mirëbesimit për Reagim dhe Rimëkëmbje nga Covid-19 i KB-

së me 9-tonë (916 700 PMP). UNICEF-i i vlerëson përpjekjet e donatorëve, institucioneve dhe partnerëve të tjerë dhe është i përkushtuar ta vazhdojë këtë partneritet të fortë në mënyrë që t’i plotësojë nevojat e personave të prekur nga Covid-19.

Selimi: Kosova ka ndërtuar legjislacion bashkëkohor për drejtësinë për të mitur

PRISHTINË, 19 QERSHOR (ER) - Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, të premten ka pritur në takim shefin e Zyrës së UNICEF-it në Kosovë, Murat Sahin.

Ministri Selimi, gjatë diskutimit me Sahinin, ka falënderuar UNICEF-in për mbështetjen që ua ka dhënë institucioneve të Republikës së Kosovës përmes programeve të tyre, me theks të veçantë për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në vendin tonë. Gjatë këtij takimi u potencua

nevoja për një zbatim më efektiv të legjislacionit ekzistues dhe bashkëpunim më të madh mes niveleve të ndryshme të autoriteteve përgjegjëse në këtë drejtim. Sipas ministrit Selimi, Kosova ka ndërtuar legjislacion bashkëkohor për drejtësinë për të mitur në bashkëpunim të ngushtë me UNICEF-in, ligje këto të cilat janë të zbatueshme për të gjithë fëmijët në territorin e Kosovës.

Po në takim palët biseduan për riintegrimin e të miturve të

burgosur, adresimin e çështjeve për mbrojtjen e fëmijëve viktime të veprave penale dhe për mundësitë për ta bërë drejtësinë për të miturit më të qasshme dhe më të kuptueshme për ta.


Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, u siguroi për mbështetje të mëtejme nga UNICEF-i përmes projekteve të përbashkëta për ta avancuar më tej fuqizimin e kuadrit ligjor dhe institucional për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Kosovë.



Bahtiri mban takim virtual me Asambleenë Komunale të Fëmijëve

MITROVICË, 19 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, së bashku me drejtorin e Arsimit, Egzon Jashari, të premten kanë mbajtur një takim virtual përmes platformës digjitale "Zoom", me kryesuesen e asamblesë komunale të fëmijëve, Adea Tahiri, përfaqësuesen e OJQ "Syri i Vizionit", Teuta Uka, dhe përfaqësueset nga organizata "Save The Children", Zyra në Kosovë.

Ky takim është realizuar në formë debati, ku kryesuesja e asamblesë komunale të fëmijëve ka parashtruar disa pyetje dhe rekomandime të nxjerra nga ana e fëmijëve asamblistë lidhur me sfidat e fëmijëve gjatë kësaj kohe të pandemisë në fushën e arsimit, shëndetësisë e sigurisë si dhe për angazhimin e komunës gjatë dhe pas pandemisë.



Fillimisht kryesuesja Tahiri ka shpalosur disa prej kërkesave dhe rekomandimeve të fëmijëve asamblistë, si: përmirësimi i infrastrukturës shkollore, shqyrtimi i mundësive buxhetore për pajisjen e nxënësve me mjete teknologjike (laptopë, tabletë) dhe çështje të tjera të cilat lidhen

me procesin mësimor. Ndërsa kryetari Bahtiri i njoftoi pjesëmarrësit mbi planet e ekzekutivit komunal që ndërlidhen me çështjet e fëmijëve dhe të nxënësve, me theks të veçantë angazhimin e psikologëve në shkollat e mesme dhe shkollat me numër të madh

të nxënësve, mbulimin me kabinete, krijimin e kushteve më të mira për gjithëpërfshirje të fëmijëve me nevoja të veçanta, si dhe për vazhdimin e projekteve për rregullimin e infrastrukturës dhe mjedisit shkollor. "Edhe në këndin e organizimit të brendshëm dhe të investimeve kapitale kemi plane konkrete mbi funksionimin e shkollave, po ashtu në bazë të nevojave kemi finalizuar projekte që do ta përmirësojnë edhe më tutje gjendjen e infrastrukturës dhe mjedisit shkollor, disa prej të cilave veçse kanë filluar së ekzekutuari", ka thënë Bahtiri.

Po ashtu, drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit, Egzon Jashari, shpalosi organizimin dhe funksionimin e drejtorisë dhe shkollave gjatë mbajtjes së mësimin në distancë. "Ky vit shkollor ka qenë i veçantë sa iu

përket ngjarjeve me të cilat është ballafaquar jo vetëm personeli arsimor. Mësimi në distancë si alternativa më e mirë ka sjellë një përvojë të re dhe sigurisht që do të vazhdojë së aplikuari edhe në të ardhmen. Gjatë kësaj periudhe, së bashku me shkollat përmes 'pikave të kontaktit', kemi shkëmbyer informacionet dhe rekomandimet mbi rrjedhën e procesit të mësimin në distancë dhe hapat përcjellës", ka thënë drejtori Jashari.

Takimi i mbajtur është zhvilluar në kuadër të programit tematik në fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe qeverisjes me të drejtat e fëmijëve "Detyrimi ynë për të ardhmen - mbrojtja e fëmijëve dhe qeverisja e të drejtave të fëmijës", i cili zbatohet nga organizata Syri i Vizionit në partneritet me Save the Children, Zyra në Kosovë.

Limaj u uron punë të mbarë zëvendësministrave të Nismës

PRISHTINË, 19 QERSHOR (ER) - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, u ka uruar punë të mbarë zëvendësministrave të propozuar nga kjo parti, të cilët tashmë janë emëruar nga kryeministri Avdullah Hoti. "Ju uroj punë të mbarë në Qeverinë e re të Republikës së Kosovës, zëvendësministrave të propozuar

nga Nisma Socialdemokrate dhe të emëruar nga kryeministri Hoti: Valdete Dushica-Bajrami, zëvendësministre e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Zafir Berisha, zëvendësministër i Punëve të Brendshme, Bekim Brestovci, zëvendësministër i Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe Enver Hoti, zëvendësministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe

Zhvillimit Rural", ka shkruar Limaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka thënë se Zafiri, Valdetja, Enveri dhe Bekimi janë kuadro të jashtëzakonshme dhe secili më i përgatitur së tjetri, të cilët, sipas tij, do t'i kryejnë detyrat shtetërore me përgjegjësi dhe me përkushtim të lartë. "Ju priftë e mbara!", ka shkruar Limaj.



Qeveria e Kosovës i ofron mbështetje Luginës së Preshevës



PRISHTINË, 19 QERSHOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka pritur të premten në takim përfaqësuesit e Preshevës, të Bujanocit dhe të Medvegjës, me të cilët ka biseduar për proceset e përgjithshme në vend, për situatën e krijuar nga pandemia Covid-19 dhe për sfidat me të cilat po përballen qytetarët si pasojë e

kësaj pandemie. Hoti me këtë rast ka shprehur përkushtimin e Qeverisë së Kosovës për mbështetjen e vazhdueshme të qytetarëve të Luginës së Preshevës. Po ashtu, ai ka theksuar gatishmërinë e Qeverisë së Kosovës për forcimin e bashkëpunimit me përfaqësuesit politikë të Preshevës, të Bujanocit dhe të

Medvegjës si dhe për përkrahjen për këto tri komuna në fushën ekonomike, të infrastrukturës, kulturës dhe arsimit. Ndërsa përfaqësuesit e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës e kanë falënderuar Hotin për pritjen dhe për përkushtimin e Qeverisë së Kosovës për ta vazhduar bashkëpunimin edhe në të ardhmen.

Kryeministri takon rektorët e universiteteve publike, diskuton për zhvillimet në arsimin universitar

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka prituri të premten në takim rektorët e universiteteve publike, me të cilët ka biseduar për zhvillimet në arsimin universitar në vend. Në konferencën për media, pas takimit, kryeministri Hoti ka thënë se rektorët i ka njoftuar me programin qeverisës për fushën e arsimit dhe kanë evidentuar në detaje, bashkë me zëvendëskryeministrin dhe anëtarët e kabinetit, disa prej prioritetëve më urgjente që kanë këto universitete. "U morëm vesh për takimet e rregullta sa iu përket prioritetëve që kemi në program, duke filluar nga ndryshimet e nevojshme ligjore që duhet të ndodhin në arsimin e lartë për t'i përgatitur këto institucione për nevojat e tregut të punës në Kosovë dhe më gjerë", është shprehur kryeministri Hoti, duke theksuar se rektorët e universiteteve i ka njoftuar edhe për orientimin e qeverisë për ta themeluar Fondin e përsosmërisë, për të financuar individë dhe programe të ndryshme në këto universitete, që tregojnë cilësi të lartë dhe konkurrencë në treg, në veçanti në studime të doktoratës. Po ashtu, kryeministri Hoti ka treguar se me rektorët janë pajtuar edhe për nevojën që të



punojnë së bashku për t'i profilizuar universitet publike, gjithmonë në përputhje me standardet e cilësisë dhe nevojën e tregut të punës jo vetëm në Kosovë, por edhe më gjer. "Do t'i ndihmojmë të gjitha këto institucione që t'i plotësojnë kushtet sa iu përket kërkesave që ka Agjencia për Akreditim e Kosovës dhe, gjithashtu, u pajtuam për disa veprime të menjëhershme që duhet të ndodhin në arsimin e lartë publik sa i përket miratimit të statuteve në Kuvendin e Kosovës të

universiteteve, në mënyrë që këto universitete të kenë mundësi ta rrisin pavarësinë dhe autonominë e tyre nga Ministria e Arsimit, përfshirë edhe pavarësinë financiare, duke filluar nga 1 janari i vitit 2021", ka deklaruar kryeministri Hoti, i cili ka falënderuar rektorët për praninë dhe mirëkuptimin që të ulen bashkë dhe të punojnë në disa grupe punese për ndryshimet ligjore dhe për planin gjithëpërfshirës për profilizimin e institucioneve të arsimit të lartë. Rektor i Universitetit të

Prishtinës, Marjan Dema, duke folur për takimin me kryeministrin Hoti dhe rektorët e tjerë, ka thënë se kjo ishte një nismë që vërtet ka munguar, që të kenë takime me kryeministrin. "U pajtuam për shumë vendime, për shumë ndryshime pozitive që duhet të ndodhin në arsimin e lartë dhe të gjithë ishin të një mendimi që së bashku ato ndryshime pozitive mund t'i bëjmë realitet dhe ky realitet do ta ketë efektin e vet që nesër, pasnesër, të përgatisim të diplomuar, të cilët do të jenë liderë të mirë,

inovativë, do të kenë ide", është shprehur rektori Dema. Ndërsa kryesuesi i Konferencës së Rektorëve, njëkohësisht rektor i Universitetit të Gjilanit "Kadri Zeka", Bajram Kosumi, pasi ka falënderuar kryeministrin për qasjen ndaj politikave të arsimit të lartë, tha se sot u bisedua për politikën kryesore të qeverisë në arsimin e lartë dhe se kjo është një qasje shumë pozitive që të flitet me përgjegjësit kryesorë për arsimin e lartë, që janë universitetet publike dhe rektorët e këtyre universiteteve.

Ambasadori britanik interesohet për menaxhimin e situatës me Covid-19



PRISHTINË, 19 QERSHOR (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka prituri të premten në takim ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Nicholas Abbott, i cili ishte i shoqëruar nga Sam Paice, udhëheqës i departamentit politik në këtë ambasadë. Në këtë takim ministri Zemaj ka falënderuar ambasadorin Abbott për mbështetjen e Mbretërisë së Bashkuar për Kosovën si në rrafshin politik, po ashtu edhe në atë shëndetësor. Më tutje, ai ka thënë se MSh-ja ka mobilizuar kapacitetet njerëzore dhe infrastrukturën shëndetësore për një përgjigje sa më adekuate ndaj Covid-19 në këtë fazë të lirimit të masave, kurse ka theksuar se vendimet për lirimet e tjera eventuale do të merren bazuar në rekomandimet e dhëna nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike sipas

situatës epidemiologjike në terren. Ai e ka siguruar ambasadorin Abbott se sistemi shëndetësor në Kosovë është vënë në funksion të mbrojtjes së shëndetit të secilit qytetar të vendit, ndërkohë që është vlerësuar edhe asistencën ndërkombëtare për Kosovën në menaxhimin e Covid-19. Ministri Zemaj e ka njoftuar ambasadorin britanik edhe me prioritetet e programit për shëndetësinë. Ndërsa ambasadori Abbott e ka inkurajuar MSh-në për zbatimin e masave të ndërmarra dhe ka theksuar nevojën që mesazhet për qytetarët të jenë shumë të drejtpërdrejta dhe ta kuptojnë që esenca e një reagimi të përgjegjshëm në këtë kohë nënkupton bartjen e maskave, ruajtjen e distancës fizike, higjienës së lartë dhe zbatimin e gjitha masave të ndërmarra.

Nga 1 korriku Kosova dhe Shqipëria, me platformë të përbashkët turistike

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, ka pritur në takim ministrin e Turizmit dhe Mjedisit të Shqipërisë, Blendi Klosi. Pas këtij takimi, Krasniqi në një konferencë ka thënë se me ministrin Klosi kanë diskutuar për fillimin e sezonit turistik, duke njoftuar se nga 1 korriku Kosova dhe Shqipëria do ta kenë një platformë të

përbashkët turistike. “Sot ndihem jashtëzakonisht i nderuar për vizitën e institucioneve nga Shqipëria. Diskutuar lidhur me turizmin e të dy shteteve, për mundësitë e bashkëpunimit në të ardhmen. U pajtuam në fillim të korrikut ta bëjmë hapjen e sezonit të verës”, ka thënë Krasniqi, duke bërë me dije se në fund të nëntorit do të hapet sezoni dimëror në Kosovë. “Në fund të nëntorit do ta bëjmë hapjen e sezonit dimëror në

Kosovë. U pajtuam për një platformë të përbashkët të të dy vendeve”, është shprehur Krasniqi. Ndërsa ministri i Turizmit dhe Mjedisit të Shqipërisë, Blendi Klosi, ka thënë se me këtë platformë të përbashkët duan të dalin me një ofertë jo vetëm për shqiptarët e të dy vendeve, por edhe për turistët nga vendet e tjera. “Si një promotor të jashtëzakonshëm të ekonomisë së shqiptarisë, deti shqiptar është i të gjithë

shqiptarëve, alpet janë të përbashkëta. Diskutuar për një platformë të përbashkët turistike, për një ofertë për vendet e tjera, sidomos për vendet e largëta”, ka thënë Klosi.

Më tutje, Klosi ka thënë se Shqipëria dhe Kosova kanë dëshmuar se sistemi shëndetësor mund ta luftojë koronavirusin, duke garantuar shëndetësi për të gjithë turistët që do ta vizitojnë shtetin shqiptar. “Me dy bashkitë do të

donim të ftonim të gjithë qytetarët që të vazhdojnë të jenë turistët më të mirë që ka Shqipëria. Në Shqipëri dëshmuam, ashtu si në Kosovë, se sistemet shëndetësore ia dolën dhe mund të garantojmë një siguri shëndetësore, por që rekomandimet do të zbatohen në rigorozitet”, ka thënë Klosi, duke premtuar ulje çmimesh gjatë sezonit turistik. “Nuk ka shans të ketë rritje çmimesh. Do të kemi ulje çmimesh”, është shprehur Klosi.



Pensionistët s'kanë obligim të lajmërohen në zyrat për pensione



PRISHTINË, 19 QERSHOR (ER) - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) ka njoftuar të gjithë pensionistët se deri në kalimin e situatës pandemike nuk janë të obliguar të paraqiten në zyrat e pensioneve për t'u lajmëruar. Në njoftimin e kësaj ministrie është thënë se ky vendim është marrë me qëllim të

parandalimit të përhapjes së Covid-19 dhe zbatimit të masave të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) në mbrojtjen e shëndetit të tyre. “Të gjithëve do t'u realizohet pagesa e pensioneve pa asnjë ndalesë deri në tejkalimin e kësaj situatë dhe

rekomandimeve të tjera nga MSH/IKShPK dhe qeveria. Të gjithë pensionistët të cilët fitojnë të drejtën për herë të parë në pension, nëse nuk kanë mundësi të paraqitjes fizike në zyrat e pensioneve, do t'u njihet e drejta dhe përfitimet për pension nga data e pensionimit”, ka njoftuar MPMS-ja.

Abrashi dhe Minxhozi diskutuan për bashkëpunimin në fushën e infrastrukturës

PRISHTINË, 19 QERSHOR (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, të premtën ka pritur në takim ambasadorin e Shqipërisë në Kosovë,

Qemal Minxhozi. Në këtë takim njoftues, Abrashi dhe Minxhozi kanë diskutuar për bashkëpunimin e mundshëm Kosovë-Shqipëri në fushën e

infrastrukturës dhe të transportit. Mes të tjerash, u theksua nevoja për bashkëpunim ndërkufitar, për hapjen e pikave të reja kufitare

dhe për mundësinë e investimeve në portin e Durrësit, në veçanti në pjesën e cila do të shfrytëzohej në mënyrë ekskluzive nga Kosova.



53 milionë euro për sektorin e bujqësisë



Të premten është nënshkruar Programi për Zhvillim Rural dhe ai i Pagesave Direkte në vlerë prej 53 milionë euro. Kryeministri Avdullah Hoti e vlerësoi këtë si një ngjarje të rëndësishme për gjithë sektorin bujqësor dhe për të gjithë ata që përfaqësojnë sektorë të ndryshëm të bujqësisë

EPOKA ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, të premten mori pjesë në ceremoninë e nënshkrimit të Programit për Zhvillim Rural dhe Programit të pagesave direkte.

Me këtë rast, kryeministri Hoti vlerësoi këtë si një ngjarje të rëndësishme për gjithë sektorin bujqësor dhe për të gjithë ata që përfaqësojnë sektorë të ndryshëm të bujqësisë. "Besoj është ndër zhvillimet kryesore që ndodh gjatë vitit dhe më vjen mirë që keni një bashkëpunim

të mirë me ministrin e Bujqësisë në këtë drejtim. Unë jam vërtet i nderuar të jem i pranishëm gjatë ceremonisë të nënshkrimit të programeve nga ana e ministrit të Bujqësisë, të cilat besoj se keni pasur mundësi t'i diskutoni së bashku, të jeni plotësisht të njoftuar për dizajnimin e programit, e pastaj për zbatimin në praktikë të atyre programeve", ka thënë kryeministri Hoti.

Hoti ka bërë me dije se këtë vit kjo çështje është e rëndësishme së veçantë, duke pasur parasysh kushte nëpër të cilat kemi kaluar gjatë këtyre tre-katër

muajve të fundit si rezultat i pandemisë, ku bujqit, fermerët kanë kaluar në një periudhë të vështirë, ku kulturat bujqësore të hershme në pranverë pothuajse kanë shkuar krejt pa pasur mundësi të dalin në treg, e pastaj edhe për shkak të të reshurave të fundit dhe breshrit etj. "Plot bujq gjithandej nëpër Kosovë janë dëmtuar bukur shumë. Kur përballemi me situata të tilla, kur shoqëritë, ekonomitë izoloohen plotësisht, e shohim sa e rëndësishme është që ne të kemi prodhues dhe bujq vendorë dhe të kemi kapacitete vendore që ne t'i plotësojmë nevojat", është shprehur kryeministri Hoti, duke përgëzuar ministrin për punën që ka bërë deri më tash. Kryeministri Hoti, po ashtu, bëri publik qëndrimin e qeverisë që është edhe pjesë e Programit Qeverisës për mbështetjen dyfish më të madhe të sektorit të bujqësisë nga pakoja për rimëkëmbje

ekonomike. "Kjo që nënshkruani sot është pjesë e buxhetit të rregullt të Ministrisë së Bujqësisë për programin bujqësor, ndërkaq sapo të miratohet buxheti në Kuvendin e Kosovës, të cilin e kemi kaluar në qeveri tash shpejt, në kuadër të Fondit që është 384 milionë euro për rimëkëmbje ekonomike si ndihmë bizneseve, qytetarëve dhe bujqve, pjesa e bujqësisë do të ketë një përkrahje të konsiderueshme në ato masat që besoj i keni parë në programin tonë për rimëkëmbje ekonomike", ka thënë Hoti. Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Besian Mustafa, ka pohuar se përkrahja e bujqësisë dhe zhvillimit rural siguron qëndrueshmëri financiare, rritje të aktivitetit biznesor dhe përfitime socio-ekonomike jo vetëm për bujqit dhe banorët në zona rurale, por për të gjithë shoqërinë, ekonominë dhe shtetin e

Kosovës. "Janë këta fermerë dhe këto agro-biznese që prodhojnë ushqimin tonë, nga toka jonë, për familjet tona", tha ministri Mustafa, duke shtuar se në shërbim të fermerëve dhe agro-përpunuesve, MBPZHR ofron dy programe përkrahëse dhe zhvillimore: Programin për Zhvillimin Rural dhe Programin për Pagesat Direkte. Më tej, ministri Mustafa ka thënë se me një buxhet ekzistues, gjithsejtë 53 milionë euro, këto dy programe do të ofrojnë një injektim financiar më se të nevojshëm për likuiditetin dhe zhvillimin e fermerëve dhe agro-përpunuesve tanë, veçanërisht gjatë këtij viti mjaft sfidues për bujqësinë si pasojë e pandemisë me Covid-19. "Bujqësia do të përfshihet me një shumë substanciale, në formë të subvencioneve, në Pakon e Rimëkëmbjes Ekonomike, që pritet të miratohet dhe zbatohet së shpejti", ka deklaruar ministri Mustafa.

Reçica me përfaqësuesen e UNDP-së diskutoi për mundësinë e mbështetjes së sektorit privat

PRISHTINË, 19 QERSHOR (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, është takuar të premten me përfaqësuesen e përhershme të UNDP-së në Kosovë, Maria Suokko, me të cilën ka diskutuar për harmonizimin e veprimeve në funksion të mbështetjes së prioritetëve të

MPMS-së, veçmas në rrethanat e tanishme të pandemisë.

Reçica e ka falënderuar Suokko për kontributin që UNDP-ja i ka dhënë MPMS-së, në përgjithësi Kosovës, përmes projekteve të rëndësishme, veçmas për rritjen e mundësive për përfshirjen e të rinjve në punësim.

Në fund të takimit, ministri i Punës dhe përfaqësuesja e përhershme e UNDP-së në Kosovë, Maria Suokko, janë pajtuar për ta thelluar bashkëpunimin në projekte të radhës, me fokus mbështetjen e sektorit privat, i cili është ndër më të dëmtuarit pas përhapjes së Covid-19.



Këshilli i Drejtorëve në Malishevë diskutoi për ecurinë e projekteve dhe për zbatimin e masave ndaj Covid-19

MALISHEVË, 19 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, të premten ka mbajtur mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, ku temë diskutimi ishin ecuria e realizimit të projekteve apo investimeve kapitale si dhe zbatimi i masave mbrojtëse në raport me pandeminë me Covid-19. Me këtë rast, drejtorët e drejtorive përkatëse kanë raportuar për ecurinë e realizimit të projekteve si dhe për sfidat që këtë vit janë duke u përballur për shkak

të pandemisë sepse janë shënuar vonesa të mëdha gjatë muajve mars, prill dhe maj dhe si pasojë disa projekte janë vonuar në realizim, kryesisht projektet dyvjeçare. Po në këtë mbledhje është diskutuar edhe për zbatimin e masave mbrojtëse në raport me pandeminë Covid-19. Edhe pse Malisheva nuk ka asnjë rast aktiv me koronavirus, zbatimi i masave mbrojtëse dhe i të gjitha rekomandimeve dhe vendimeve të institucioneve përgjegjëse është obligues.



Kryetari Begaj, për të dy temat e diskutuara, ka kërkuar nga drejtoritë përkatëse angazhim maksimal si për realizimin e projek-

teve, po ashtu edhe për zbatimin e masave mbrojtëse. Për këtë të fundit, Begaj ka urdhëruar mbajtjen e detyrueshme të maskave për të gjithë stafin e administratës si dhe për të gjithë ata që duan të kryejnë shërbime brenda komunës. Edhe me këtë rast u kërkua që edhe të gjitha bizneset private t'i zbatojnë masat, me theks të veçantë sektori i gastronomisë, si dhe u kërkua angazhim edhe më i madh nga ana e inspektoratit që ta mbikëqyrë zbatimin e këtyre masave.

Komuna e Gjilanit bën thirrje për kujdes maksimal për parandalimin e Covid-19

GJILAN, 19 QERSHOR (ER) - Nënkryetari i Komunës së Gjilanit, Arbër Ismajli, në konferencën me gazetarë të mbajtur të premten, pas takimit me Komitetin emergjent për parandalimin e virusit Covid-19, ka kërkuar respektim të rekomandimeve të institucioneve shëndetësore dhe vendimeve të organeve të shtetit në mënyrë që të ketë sa më pak raste në Gjilan. "Janë 12 raste të reja që kanë dalë pozitive në Gjilan, në rezultatet e fundit të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik dhe jemi duke vazhduar t'i marrim mostrat varësisht nga kontaktet që kanë pasur të infektuarit. Dje janë marrë 70 mostra të kontaktit dhe sonte i presim rezultatet e tyre. Edhe sot janë marrë mostrat dhe do të përpunohen rezultatet e tyre për të

cilat do të jeni të njoftuar. Apeloj të ruheni sa më shumë dhe t'i respektojmi rekomandimet që dalin nga institucionet e shtetit në nivel qendror dhe lokal", ka thënë Ismajli. Ai ka konfirmuar se inspeksioni i Komunës së Gjilanit dhe Policia e Kosovës është vazhdimisht në terren dhe kërkohet që të gjithë ata që janë disgnostifikuar pozitivë në testet me Covid-19, të qëndrojnë në shtëpi, duke përfshirë kështu edhe të gjithë ata që kanë qenë në kontakt me ta sepse krijojnë rrezik për përhapje të virusit. Ajhane Sefiu, drejtoreshë e Qendrës Rajonale të Shëndetit Publik, ka konfirmuar se tashmë në Gjilan janë 46 raste aktive me Covid-19 në Gjilan dhe gjendja e



tyre është nën monitorim të vazhdueshëm deri në shërimin e plotë të tyre. "Lusim për kujdes maksimal të të gjithë qytetarëve

dhe për përdorimin e masave mbrojtëse. Të infektuarve u kërkohet që ta respektojnë vetizolimim si masa më e mirë e

tejkalimit të virusit", ka thënë ajo. Alban Ramushi, komandant i Stacionit Policor në Gjilan, ka theksuar se veprimet e policisë janë strikte, duke njoftuar kështu ndërprerjen e aktiviteteve në dy lokale të natës, ku nuk respektohen rekomandimet e institucioneve të shtetit. "Apeloj të të gjitha bizneset që t'i respektojnë vendimet e shtetit, në të kundërtën do t'u mbyllen veprimtaritë dhe do të ballafaqohen me ligjin. Duhet të përdoren masat mbrojtëse dhe të përshtaten me të jetuarit në regjimin e masave mbrojtëse. Për çdo rast apo shqetësim mund të kontaktojnë në çdo kohë numrat kujdestarë 112 dhe 192 dhe do të jemi në shërbimin e tyre", ka thënë Ramushi.



Imzot Dodë Gjergji viziton Komunën e Vitisë

VITI, 19 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Vitisë, Sokol Haliti, ka pritur në takim Ispeshkvin e Ispeshkvisë së Kosovës, imzot Dodë Gjergjin, të cilin e ka njoftuar me gjendjen momentale në Komunën e Vitisë, posaçërisht me menaxhimin e situatës

kundër Covid-19 dhe ndihmë që po ua ofron qytetarëve të kësaj komune. Imzot Dodë Gjergji ka vlerësuar punën dhe angazhimin institucional të Komunës së Vitisë në menaxhimin e kësaj situatë si dhe ka përgëzuar kryetarin dhe

Komitetin Komunal për Mbrojtje dhe Shpëtim për përkushtimin e treguar gjatë kësaj periudhe. Njëkohësisht, Imzot Dodë Gjergji është pajisur edhe me certifikatën e lindjes nga Shërbimi i Ofiqarisë në Viti meqenëse është i lindur në Stubëll të Vitisë.

Ndihmohet me 13 800 euro Lorik Fazliu nga Drenasi për shërim jashtë vendit

DRENAS, 19 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka pritur në takim Muhamet Ajrullahun nga Gjilani, i cili me vetiniciativë ka grumbulluar, përmes donatorëve vullnetmirë, 13 800 euro për shërimin e Lorik Fazliut nga Drenasi i cili ka nevojë për shërimin jashtë vendit. Kryetari i komunës, Ramiz Lladrovci, ka falënderuar

Muhamet Ajrullahun dhe gjithë donatorët të cilët kanë shprehur vullnetin për t'i ndihmuar Lorik Fazliut, pesëmuajsh, i cili është diagnostikuar me leukemi akute dhe ka nevojë për shërim jashtë vendit. Edhe prindi i Lorikut ka falënderuar donatorët të cilët kanë shprehur gatishmërinë për t'i ndihmuar në shërbimin e tij jashtë vendit.



Lavdia u takon atyre që flijohen për vizione të mëdha (11)

Çfarë e bëri dhe çfarë e bën edhe sot Adem Jasharin krejt të veçantë në historinë e kombit tonë?



Bedri ISLAMI

Adem Jashari nuk është vetëm fotografia që njohim, vetëm thelbi i asaj që besojmë, nuk është vetëm streha nga e cila domosdo kanë shkuar të gjithë ata që donin të luftonin. Ai është shumë më tepër se kaq. Edhe shumë vite pas rënies së tij, mjaft njerëz që kishin pozicione drejtuese në strukturat e luftës, kur duan të dëshmojnë një qëndrim apo të kenë një mbështetje, krejt natyrshëm i drejtohen Adem Jasharit apo faktit se kanë qenë në lidhje me të, se kanë bujtur te Jasharët, se kanë pasur kontakte ose se u kanë ndihmuar atyre. Nganjëherë, mjerisht, edhe njerëz që krejt rastësisht janë njohur me to apo u kanë bërë konak, tashmë dëshmojnë si njerëz të afërt dhe të besuar të tyre. Në fund të fundit, kjo është forca që ngjall emri i Jasharëve, sidomos i Ademit, Bacës Shaban dhe Hamzës dhe ne duhet ta pranojmë si të tillë. Jasharët, duan apo nuk duan, nuk do të mund t'i shmangen kurrë mbështetjes që kërkojnë të tjerët tek emri i tyre.

- Çfarë e bëri dhe çfarë e bën edhe sot Adem Jasharin krejt të veçantë në historinë e kombit tonë?

- Cila është rrjedha përmes së cilës ka ecur e vazhdon të ecë emri i tij?
- Ishte ai thjesht luftëtar, njeriu me pushkën hedhur krahëve, i hekurt dhe i ftohtë, i pajalë dhe serioz, apo kishte shumë më tepër se kaq? Personalisht nuk e kam takuar asnjëherë Adem Jasharin. Nuk futem në radhën e njerëzve që e kanë pasur një fat të tillë në jetën e tyre. E kam dëgjuar për herë të parë emrin e tij nga Fehmi Lladrovci dhe vëllai i tij, Ramizi, që më pas do të bëhej përfaqësuesi i Adem Jasharit në perëndim, në bazë të një letre, që Grupi i Drenicës i dërgoi organizatës në dhjetorin e vitit 1997. Letra ruhet ende në arkivin e organizatës. Fehmiu, kishte një respekt të jashtëzakonshëm për të dhe mendoj se Adem Jashari ishte i vetmi njeri para të cilit përkulej Fehmi Lladrovci. Më pas do të mësoja se edhe Adem Jashari, kur i kishin kërkuar të kishte një ndarje me Fehmiun, do të thoshte se "vetëm vdekja më ndan nga Fehmi Lladrovci". Kjo ka qenë njohja ime e parë me të, përmes figurave që ishin të afërta me Adem Jasharin, por, thënë sinqerisht, nuk e kam menduar se po flisnim për njeriun që shpejt, shumë shpejt, do të bëhej figura mitike e shqiptarëve. Ishte koha kur ai sapo ishte dënuar me njëzet vite në mungesë, në gjyqin e njohur ndaj Grupit të Drenicës.

Më pas e pashë fotografinë e tij dhe më bënë përshtypje sytë e tij, të cilët, kushdo që i sheh me vërejtje, e ndjen se kanë ngjashmëri të jashtëzakonshme me të shqiptarët.

Por unë kam pasur një fat tjetër të dyfishtë: kam njohur nga afër, si mik i tyre, familjen e jashtëzakonshme të Jasharëve, të cilët kanë hisen e tyre të papërsëritshme në luftën që është zhvilluar në Kosovë. Unë mund të them me bindje se, në se nuk do të kishte qenë mbështetja e tyre e hapur dhe angazhimi në strukturat e luftës, shumë gjëra nuk do të shkonin ashtu si do të rridhnin punët më tej. Në familjen e tyre, shumë herë, më ka takuar të shoh incizimet e ndryshme familjare, krejt të zakonshme, të shoh Ademin dhe Hamzën mes familjeve të tyre, të ndjek rrjedhën e jetës që ata kanë bërë, punët e hallet e përditshme, të dëgjoj se si e kanë konceptuar jetën dhe si kanë menduar për të ardhmen e Kosovës, duke folur krejt natyrshëm, i kam parë tek lozin me fëmijët në një ditë të zakonshme, si sillëshin me prindërit, atë aktin e veçantë kur i merrnin mes duarve të tyre dorën e nënës plakë dhe e përkëdhelnin butësisht, hyrjen pa bujë e zhurmë në dhomën e miqve, deri në një ditë të zakonshme kur merreshin me punët e përditshme si do të ishte krasitja e pemëve apo çarja e drurëve në oborrin e shtëpisë.

Fati tjetër i imi lidhet me faktin se në vitet e luftës isha i zgjedhur drejtuesi kryesor i Lëvizjes Popullore të Kosovës, organizatë së cilës i kishte takuar edhe Adem Jashari që nga mesi i viteve '80-të. Në arkivin e saj ndodheshin, ose m'u dhanë më pas, mjaft kaseta, në të cilat ishin të regjistruara porositet e Adem Jasharit, mendimet e tij, qëndrimin e tij për njerëz, ngjarje dhe pozicione të ndryshme, kam dëgjuar mendimin e tij, i cili, kishte po të njëjtën peshë dhe po të njëjtën forcë si edhe lufta e tij. Ndodheshin letra të tij, të cilat ruhen edhe sot si thesar i jashtëzakonshëm, dhe përmes tyre, ndonjëra edhe është bërë publike, mund të dallosh qartësisht se pas tij nuk është vetëm njeriu i luftës, por edhe i mendimit vizionar; nuk është vetëm luftëtar, por edhe prijësi, nuk është vetëm e tashmja, por edhe përvoja që kishte shkuar; nuk është vetëm Drenica, por edhe Kosova, nuk është vetëm Kosova, por edhe kufijtë më skajorë të Shqipërisë londineze.

Adem Jasharin unë nuk e kam parë kurrë thjeshtë e vetëm si luftëtar, si dalzotës i zakonshëm i Kosovës, por shumë më tepër se kaq.

Është koha të flasim më gjatë për mendimin e tij filozofik, për vizionin e tij të jashtëzakonshëm, për përmasat që kishte rrokur mendja e tij, për krijimin edhe një herë si në legjenda të treshes së

njohur mitike; babai dhe vëllezërit; apo edhe më tej, Familja dhe Fisi, për të shkuar më gjerë, në krejt shqiptarinë.

- Cila ishte filozofia e Adem Jasharit?

- Cili ishte vizioni i tij?

- Çfarë bëri ai më shumë se gjithë të tjerët për të qenë njëkohësisht mit, legjendë dhe e vërteta e kombit tonë?

Përfytyrimi i Adem Jasharit thjesht e vetëm si një luftëtar, prijës apo edhe diçka më tepër asnjëherë nuk ka qenë i saktë. Sepse ka qenë i paplotë. Kjo është thelbësorja. Sepse ka qenë vetëm njëra anë e shfaqjes së tij, ajo më e dukshmeja, më e përfytyrueshmeja, më e kapshmeja. Ajo për të cilën është edhe më e lehtë të flitet, por që jo gjithmonë është e gjithë e vërteta. Adem Jasharin ne duhet të mësohemi ta shohim përtej këtij përfytyrimi, duhet të mësohemi ta shohim në ato përmasa që janë e vërteta e jetës së tij dhe e mendimit të tij politik, perceptimit të tij vizionar dhe e shfaqjes së tyre në kapërcyellin e shekullit të shkoj.

Shfaqja e tyre në vetvete ose një nga një ka disa ngjashmëri ose shumë ngjashmëri me shfaqje të tilla në lëvizjen tonë kombëtare, por kësaj radhe, për herë të parë ajo është një plotësi, është struktura komplekse e mendimit dhe e rezistencës, mbështetur në tiparet jo vetëm të kohës që përjetoj, jo vetëm të së shkuarës, por edhe në perceptimin e së ardhmes. Fakti që idetë që kishte mbartur Adem Jashari nuk u shuan së bashku me rënien e tij heroike, por, në të kundërtën u bënë tej mase dhe tej se zakonshmes më të fuqishme, dëshmojnë se, më shumë se gjithçka, ai kishte pasur ide që do të përgatitnin të ardhmen.

Nuk e di dhe besoj se mes tyre nuk do të jenë takuar asnjëherë Adem Jashari dhe vigani i mendimit liberator Ukshin Hoti, por jam i bindur se kanë dëgjuar për njëri

tjetrin. Ukshin Hoti ishte njëri ndër figurat e njohura të jetës politike të Kosovës që në ngjarjet e njohura të vitit 1981, ndërsa Adem Jashari, përgjithësisht Jasharët duhet të ishin të njohur për Ukshin Hotin, qoftë për ngjarjet e 30 dhjetorit të vitit 1991, qoftë edhe nga fakti se Ukshin Hoti kishte lidhje me të njëjtat struktura ilegale ku ishte pjesë edhe Adem Jashari. Sidoqoftë kjo nuk është e rëndësishme. Thelbësore se të dy ata, njëri në fushën e filozofisë së shkruar dhe tjetri në fushën e filozofisë së jetësuar, hapën njëkohësisht një fushë të re përjetimi në politikën shqiptare të Kosovës.

- Cilat ishin disa nga momentet më themelore të mendimit politik të Adem Jasharit dhe të vizionit të tij?

- Në se shpejt e shpejt, shkurt e shkurt, do të thonim se ishte liria e Kosovës dhe bashkimi i kombit - kjo ishte një aspiratë shekullore, thuajse e të gjithë shqiptarëve në Kosovë. Për të arritur në këtë aspiratë duheshin përcaktuar qartësisht saktë rrugët që do të përshkruheshin, perspektivat që do përcaktoheshin, duhej bërë një gjë e cila, aq sa do të ishte pa kthim, aq edhe do të ishte mrekullisht e dëshiruar, të paktën nga ata që do të ishin në gjendje të bënin luftën.

Djemtë e Shaban Jasharit, pas jetesës më shumë se 300-vjeçare në Prekaz kishin krijuar lidhjet e tyre me tokën. Kjo ishte një lidhje e shumanshme, jo vetëm jetësore, e përditshme, por edhe në motivin e tyre të qëndresës. Hamzë Jashari do të thonte në njëherë nga bisedat e tij të lira se "këtu kemi lindur, këtu do të jetojmë, këtu do të vdesim, përtej kësaj toke nuk kemi se ku të shkojmë". Ishin fjalë profetike. Dihet tashmë se në disa nga muajt e vitit 1991 Adem Jashari dhe disa nga bashkëlufetarët e tij do të jenë në Shqipëri, në atë që

do të quheshin ushtrime ushtarake. Është i njohur fakti se gjithçka ishte dekonspiruar, por kjo nuk është në temën e këtij shkrimi.

Si çdo gjë që lidhej me luftën, Ademi e kishte marrë gjithçka shumë seriozisht dhe do i thotë djemve të grupit të Drenicës se "Kush ia ka mësyre kësaj rruge, duhet me e ditë mirë çka mundet me ndodhë dhe këtu nuk ka hajgare, ia kemi nisë kësaj pune dhe duhet t'i shkojmë deri në fund, pavarësisht se si do të shkojë ajo, me rreziqe apo pa to".

Pas arrestimeve masive të grupeve të ndryshme që u stërvitën në Shqipëri, para shumë kujt u shtrua pyetja se çfarë duhej bërë. Ishin të shumtë ata që morën rrugën e mërgimit. Disa e humbën emrin e tyre, disa nuk e ditën as vetë se nga do të shkonin, të paktë ishin ata që vazhduan të mbeten në rrjedhat e luftës dhe, edhe më të paktë, ata që u kthyen. Adem Jasharit, qeveria e asaj kohe, e quajtur e Bukoshit, i propozoi rrugën e mërgimit. Çfarë do të kishte ndodhur në se edhe ai, si jo pak të tjerë, do të kishte bërë të njëjtën gjë.. do të rrugëtonte dhe do të kthehej në një mërgimtar të zakonshëm. Ai edhe mund ta bënte këtë, askush nuk ishte zot i fatit dhe i jetës së tij. Mirëpo Adem Jashari e kishte mendimin e tij të pjekur politik dhe ky është guri i parë themeltar i çdo qëndrese: për vend tonë duhet të luftojmë në vendin tonë. Nuk na bën mirë as buka e të huajit, as ngrohja e të huajit, as fjala e të huajit. Ai pra mund të rrinte, ta zëmë në Gjermani, mirëpo është nga gjërat e para që nuk i shkon ndër mend. Ndoshta mund edhe të ketë dëgjuar se një profesor i nderuar, ish i burgosuri politik Ukshin Hoti e kishte lënë Universitetin famëmadh të Harvardit për të bërë politikë në Krushën e Madhe, ndoshta edhe jo. Por ai bëri të njëjtën gjë, me të njëjtin mendim politik e filozofi politike të qëndresës: lufta duhet filluar nga vendlindja.

Mendimi i tij ishte pjekur me kohë - nuk ishin dashur vështirësi të mëdha për të pasur një mendim të tillë, aq më tepër në një fis ku ai kishte lindur dhe ku kishte formuar karakterin e tij.

Adem Jashari kthehet në Prekazin e Poshtëm.. Asgjë të veçantë nuk ka në këtë fshat bri Skenderajt. Katër lagje: Jasharaj, Kodra, Meha dhe Lushtaku. Tri lagjet e para janë krijuar prej tre vëllezërve: Jasharit, Kadriut dhe Mehës, prandaj edhe janë të një gjaku, ndërsa Lushtakët ishin të ardhur disi më vonë në Prekaz.

Megjithatë ky ishte dheu i tij, ai e dinte se nuk mund të shkonte diku tjetër dhe t'u thoshte të ngriheshin në luftë, në se nuk e kishte zgjidhur më parë një gjë të tillë në fshatin dhe në gjakun e tij. Atdheu fillon nga vetja - thonë dhe kjo, në rastin e Jasharëve dhe të Prekazit të Poshtëm, është më se e vërtetë. (Vijon)



E jashtëzakonshme

Polakja me flokët më të gjata sesa trupin

Kur Malgorzata Kulczyk dëshiron të relaksohet, ajo i zgjidh flokët dhe i lë të përhapen në tërë trupin e saj, që kanë një gjatësi 1.5 metra. Në fakt, ajo i ka më të gjata flokët sesa tërë trupin dhe pranon se pakkush beson se i ka natyrale dhe se nuk bëhet fjalë për parukë. Malgorzata, 34-vjeçare që jeton në Londër, thotë se kishte filluar t'i rritë flokët kur ishte shtatëvjeçare dhe për herë të fundit kur i kishte prerë kishte ndodhur pesë vjet më parë.



BARSOLETA E DITËS



- Kjo është e tmerrshme, - bërtiti mësuesja.
- Ti Astrit fle gjithë orën e mësimit. Nga do të mësosh ti?
- Në ëndërr po shikoja pikërisht një orë mësimi, mësuese.



Në Kino ABC nuk ka shfaqje

FOTO E DITES



Tymi si pasojë e djegies së gomave gjatë një proteste në Barcelonë mbulon logon e fabrikës Nissan. /AP/

U dogj në 85% të trupit 53-vjeçares në garë për çmimin 'Portrait of Humanity 2020'

53-vjeçarja Carol Mayer nga Queensland, Australi, pësoi djegie në rreth 85 përqind të trupit gjatë një zjarri që përfshiu shtëpinë e saj dy dekada më parë. 'Ish-mbretëresha e bukurisë', për të cilën u tha që kishte vetëm 50 përqind mundësi për të mbijetuar pas incidentit, ka pozuar disa foto të veçanta. Fotot nudo të shkrepura nga fotografi me origjinë nga Londër, Brian Cassey, dhe që janë titulluar 'Skin The Skin I'm In' janë listuar në tabelën për çmimin Portreti 'Humanity 2020'. Carol dhe djali i saj i mbijetuan flakës së tmerrshme, por Carol

mori plagë që i ndryshuan jetën. Tani, 53 vjeçarja, e cilësuar edhe si 'ish-mbretëresha e bukurisë thotë': Me djegiet është e vështirë fizikisht dhe mendërp-



isht për çdo njeri që të kalojë. Por nëse e keni atë frymë të vërtetë luftarake, atë që unë kam, kjo është ajo që më ka ripërtëritur, mirësjellje dhe vendosmëri.

E rrallë

Adoleshenti britanik qëndron i varur në mbi 180 metra lartësi

Një adoleshent britanik ka publikuar një video në internet, ku shihet se si bën akrobacione jashtë rrethojës mbrojtëse të një ndërtese të lartë në Londër. Ai madje nuk heziton të mbahej me vetëm njërën dorë në rrethojën e katit të 53-të. Adam Lockwood, 19-vjeçar, postoi videon duke rrezikuar jetën në kulmin e ndërtesës



Madison në pjesën qendrore të Londrës. Ky adoleshent nga Wigan, Lancashire, njihet për akrobacitë e tij në ndërtesat më të larta nëpër Evropë, të cilat i poston në kanalin e tij zyrtar në "YouTube".



 <p>DASHI Dikush do të shprehë interes për ju, madje ka gjasa që t'i shprehë edhe ndjenjat. Është momenti i duhur për ata që janë në kërkim të dashurisë.</p>	 <p>DEMI Do të jeni i zhytur në mendime. Përpiquni të qetësoheni emocionalisht, përndryshe do të përballeni me situata të papritura dhe do ta keni të vështirë të arrini ato që doni.</p>	 <p>BINJAKËT Mos rrezikoni duke dalë jashtë kapacitetit tuaj. Përpiquni të zgjidhni mënyra më të lehta për të vepruar për të qenë më të sigurt.</p>	 <p>GAFORRJA Ekziston mundësia të eliminoni një konflikt të vjetër, të krijoni raporte të reja me shefat ose t'i sheshoni problemet me partnerin/partneren tuaj.</p>	 <p>LUANI Dëshira për të realizuar diçka ekstremisht ambicioze do t'ju shfaqet sërish. Diçka tipike kjo për ju, jeni Luan dhe kërkoni t'i tregoni aftësitë tuaja.</p>	 <p>VIRGJËRËSHA Mos lejoni zilinë dhe ashpërsinë t'ju udhëheqë. Mësoni të kënaqeni me suksesin e të dashurve tuaj. Përndryshe rrezikoni të mbylleni në vetvete.</p>
 <p>PESHORJA Flisni me mikun tuaj të ngushtë për t'u ndjerë më mirë dhe rekomandohet të ushtroheni fizikisht, pasi do të ndikojë pozitivisht edhe në gjendjen tuaj psikologjike.</p>	 <p>AKREPI Planet do t'ju ndryshojnë disa herë gjatë ditës. Para se të premtoni për t'i përmbushur kërkesat e dikujt, mendoni për pasojat.</p>	 <p>SHIGJETARI Rrezikoni të harroni një premtim që i keni bërë vetes. Bëni kujdes me regjimin ushqimor, pasi mund t'u ktheheni zakoneve të vjetra.</p>	 <p>BRICJAPI Mos jepni përgjigje standarde dhe mos flisni vetëm për motin. Ekziston mundësia ta tërhiqni vëmendjen e personit që ju pëlqeni.</p>	 <p>UJORI Ka gjasa të mos ndiheni komod gjatë ditës, mbi të gjitha në sferën profesionale. Do t'ju duhet të komunikoni me një koleg të cilin nuk e keni pëlqyer asnjëherë.</p>	 <p>PESHQIT Ekziston mundësia të nisni një aventurë, e cila rrezikon të mos ketë sukses. Bëni shumë kujdes nëse ndërmerrni një hap të tillë dhe mos u bazoni vetëm te fati.</p>

Vanessa bllokoi faqet e fansave të Kobes dhe Gianna Bryant në rrjetet sociale



Janë bërë pothuajse gjashtë muaj që kur basketbollisti Kobe Bryant dhe vajza e tij, Gianna, kanë ndërruar jetë. Tashmë anëtarët e tjerë të familjes janë duke njoftuar për të rejtat, teksa theksojnë se po mundohen të ecin përpara, shkruan "Daily Mail". Në një postim në rrjetin social "Instagram", Vanessa Bryant, ka informuar ndjekësit se ajo dhe vajza e saj kanë bërë disa veprime në pro-

filet e të ndjerëve. Ajo kishte shpjeguar se i është dashur që t'i bllokoi profilet e Kobes dhe Giannas në rrjetet sociale, pasi fotografitë e tyre po i bëjnë të ndihen në siklet. "Faleminderit për të gjithë dashurinë! Natalia dhe unë, fatkeqësisht, kemi bllokuar profilet, sepse ka qenë e vështirë të jemi në rrjete sociale dhe të shohim në mënyrë konstante fotografitë e më të dashurve tanë", ka shkruar ajo.



Meghan dhe Harry, shpenzime pa fre për sigurinë

Qetësia dhe privatësia janë gjëra nga të cilat nuk kanë ndërmend të heqin dorë dhe për të garantuar nuk janë kursyer. Në vetëm katër muaj në Kanada, Herry dhe Meghan Markle kanë shpenzuar rreth 50 mijë euro për sigurinë. Shifër që është kritikuar nga kontribuesit në vendin amerikano-

verior dhe që tani duan ripagim. Që kanadezët nuk e kishin pritur mirë largimin e dukëve kjo nuk është risi. Shumëkush druante se do ta gjente veten teksa paguante shpenzimet për strehimin e çiftit dhe sipas një kërkimi të Times, 73 për qind e popullatës nuk kishte ndërmend të paguante për ta.

Genc Prelvukaj zbulon datën e publikimit të albumit të ri



Genc Prelvukaj ka gëzuar fansat me postimin e fundit të bërë në "Instagram", ku flet për planet muzikore. Këngëtari pritet që brenda një kohe të shkurtër të lansojë një projekt të ri


muzikor, ndërsa gjatë muajve të fundit të vitit ta publikojë edhe albumin e tij të ri. Ky do të jetë i teti me radhë për artistin, e që do të publikohet pas disa muajsh, më 15 nëntor.

Rihanna dhe Jack Dorsey dhurojnë 15 milionë dollarë për shërbimet e shëndetit mendor



Këngëtarja dhe sipërmarrësjja 32-vjeçare, në një përpjekje të përbashkët me shefin ekzekutiv të "Twitter"-it, Jack Dorsey dhe iniciativën e tij '#StartSmall', po dhurojnë 15 mil-

ionë dollarë nga fondacioni jofitimprurës, 'The Clara Lionel Foundation', për shërbimet e shëndetit mendor në mes të kohëve sfiduese sociale dhe pandemisë koronavirus, shkruan "Daily Mail".



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Fetahu: Gjakova, Istogu dhe Ferizaj, të gatshëm për zhvillim dhe avancimin e basketbollit

Kryetari i FBK-së, Arben Fetahu, ka vizituar Gjakovën, Istogun dhe Ferizajn. Ai gjatë vizitave në këto komuna ka kërkuar nga kryetarët Ardian Gjini, Haki Rugova dhe Agim Aliu që të përkrahen edhe më shumë klubet e basketbollit. "Përveç mbështetjes që klubet tona të këtyre qyteteve e kanë marrë deri më tani dhe do ta marrin në vazhdim nga komunat përkatëse, ne si FBK-ja jemi zotuar se do të vazhdojmë të kontribuojmë për zhvillimin e këtyre skuadrave, por edhe basketbollit në përgjithësi në këto qytete", ka thënë Fetahu



zgjerimin e veprimtarisë të vajzat dhe grupmoshat e tjera. Pas takimit, me ftesë të nikoqirit, kryetari Rugova u zhvillua një vizitë në palestrën e mrekullueshme të Istogut, punimet në të cilën janë në finalizim e sipër, për të parë për së afërmi kushtet infrastrukture në të cilat sporti istogas pritet t'i zhvillojë garat nga vjeshta e tutje.

Në takim me kryetarin e Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, është biseduar për riaktivizimin e basketbollit të meshkujve në qytetin e dytë në Kosovë sa iu përket kapaciteteve ekonomike. Kthimi i basketbollit në konkurrencën e meshkujve dhe shtimi i përkrahjes për vajzat ferizajase ishte bosht i diskutimeve të zhvilluara në atmosferë tejet miqësore dhe bashkëpunuese ndërmjet të parit të FBK-së dhe kryetarit të Komunës së Ferizajt. U premtua përkrahje e shtuar materiale dhe funksionale për rithemelimin e klubit të basketbollit nga Ferizaj dhe për projektin afatgjatë të zhvillimit të basketbollit në këtë komunë. Ideja është që së shpejti të bëhet publik lajmi për rithemelimin e KB Kastrioti dhe fillimin e garave në kuadër të FBK-së.

"Epoka e re"

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Arben Fetahu, ka zhvilluar disa takime të rëndësishme për zhvillimin dhe avancimin e basketbollit në qytete të ndryshme të Kosovës. Numri një i FBK-së është takuar me kryetarin e Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, kryetarin e Komunës së Istogut, Haki Rugova dhe kryetarin e Komunës së Ferizajt, Agim Aliu. Kryetari i FBK-së në këto takime ka qenë i shoqëruar nga anëtarë të bordit dhe zyrtarë të lartë të federatës. "Ideja e këtyre

takimeve dhe pikërisht në këto tri qytete ka qenë mbështetja e klubeve aktive nëpër këto qytete nga ana e FBK-së, por edhe atyre që pritet të riaktivizohen në ditët në vijim. Unë jam shumë i kënaqur me rrjedhën e këtyre tri takimeve sepse është e rëndësishme së veçantë që të kemi mbështetjen direkte nga njerëzit kryesorë të këtyre komunave. Përveç mbështetjes që klubet tona të këtyre qyteteve e kanë marrë deri më tani dhe do ta marrin në vazhdim nga komunat përkatëse, ne si FBK jemi zotuar se do të vazhdojmë të kontribuojmë në zhvillimin e këtyre skuadrave, por edhe

basketbollit në përgjithësi në këto qytete", ka thënë Fetahu. Kryetari Fetahu ka bërë me dije se me kryetarin Gjini kanë biseduar për kthimin e Vëllaznimit në Superligë dhe për përkrahjen e vazhdueshme që komuna ua jep dy ekipeve të basketbollit si dhe për zhvillimet infrastrukture dhe punët që duhet kryer brenda palestrës. Sipas Fetahut, është shprehur gatishmëria e komunës për ta shtuar përkrahjen për dy ekipet e Vëllaznimit (meshkuj/femra). Gjini dhe Fetahu janë pajtuar që ta thellojnë bashkëpunimin gjatë verës për të mobilizuar përkrahje edhe më të madhe

për basketbollin gjakovar dhe për ta rikthyer namin e dikurshëm të qytetit si vatër e basketbollit. Në Istog është mirëpritur vizita e kreut të FBK-së dhe përkrahja për basketbollin e Istogut nga kryetari i Komunës, Haki Rugova. Është diskutuar për palestrën që është në përfundim e sipër dhe për inaugurimin e saj me një ndeshje revyale ndërmjet KB Istogut dhe Përfaqësueses A të Kosovës në vjeshtën e këtij viti. Në këtë takim është theksuar puna e madhe dhe shembullore që KB Istogu ka bërë për zhvillimin e basketbollit dhe për idetë e mëtejme për

Drita, e pagabueshme ndaj Ferizajt



GJILAN, 19 QERSHOR - Skuadra e Dritës nga Gjilani është treguar skuadër e pagabueshme në përballje me Ferizajn, pasi ka fituar me rezultat 2-0. Mysafirët arritën të mbahen vetëm një pjesë të lojës. Kapiteni Ardian Limani në pesëmbëdhjetë minutat e para ka pasur në rast për shënim, por nuk ka arritur të jetë i saktë. Raste të mira

shënimi në pjesën e parë kanë pasur edhe Kastriot Rexha, Hamdi Namani dhe Bujar Shabani. Katër minuta pasi ka filluar pjesa e dytë, Kastriot Rexha e ka kaluar skuadrën e Dritës në epërsi. Enimi dhe Shabani nuk arritën t'i shfrytëzojnë rastet e treguara, kurse në minutën e 77-të Ardian Cuculi shënoi pas një harkimi fantastik nga Astrit Fazliu (2-0).

IPKO SUPERLIGA

Drita - Ferizaj 2-0

Të shtunën takohen:

17:00 Drenica - Flamurtari

17:00 Gjilani - Vushtrria

19:00 Prishtina - Dukagjini

Të dielën takohen:

17:00 Ballkani - Trepça '89

17:00 Feronikeli - Llapi

Prishtina sfidon kampionen në Pejë

PEJË, 19 QERSHOR - Kampionia aktuale, Besa Famgas, nuk ka asnjë humbje këtë edicion, ndërsa serinë pozitive synon ta vazhdojë edhe në finale të plejofit të Superligës së Kosovës në hendboll (meshkujt). Besa Famgas e pret Prishtinën sot (e shtunë) nga ora 18:00 në palestrën "Karagaçi". Skuadra

pejane ka planet e saj për të vazhduar me fitore, ndërsa Prishtina synon t'i prish llogaritë e Besës. Skuadra nga Peja në gjysmëfinale të plejofit e ka kaluar Kastriotin e Ferizajt, me dy fitore të thella. Prishtina ka bërë përmbyse të madhe në gjysmëfinale për të arritur në

finale. Fillimisht në kryeqytet Prishtina pësoi me tetë gola dallim nga Trepça, por të mërkurën në Mitrovicë fitoi me 11 gola dallim dhe avancoi në finale. Kampion shpallet skuadra që fiton tri pikë, përkatësisht që shënon dy fitore, apo një fitore e një barazim.



KOK-u mbështet rrugëtimin e Shatrit nga Prishtina në Tiranë

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Bordi Ekzekutiv i Komitetit Olimpik të Kosovës ka marrë vendim ta mbështesë rrugëtimin sfidues të Fikret Shatrit, i cili do të vrapojë nga Prishtina në Tiranë.

Shatri, ish-basketbollist i Prishtinës, do të vrapojë 257 kilometra me moton "Vrapi i shqipes nga Skënderbeu n'Skënderbeu". KOK-u do t'i mbulojë të gjitha

shpenzimet e Shatrit që lidhen me këtë udhëtim. Ai do të nisë më 2 korrik nga Sheshi "Skënderbeu" në Prishtinë, me fillim në orën 18:00, derisa në Tiranë pritet të arrijë më 4

korrik. 45-vjeçari nga Istogu njihet për vrapime të gjata, derisa gjatë pandemisë së Covid-19 kishte vrapuar nga Prishtina deri në Istog.



Duka: Me Rejën synojmë t'i përsërisim sukseset e De Biasit

TIRANË, 19 QERSHOR - Presidenti i FShF-së, Armand Duka, njëherësh anëtar i Komitetit Ekzekutiv të UEFA-s, ka dhënë një intervistë për median italiane "TuttoMercatoWeb", ku ka folur jo vetëm për kompeticionet evropiane, por edhe për futbollin shqiptar dhe kombëtaren kuqezi. Kreu i qeverisë së futbollit ka komentuar rifillimin e kampionatit shqiptar, teksa shpreson që disa ndeshje të këtij sezoni të luhen me tifozë.

President, si po shkojnë gjërat në Shqipëri?

Kemi rinisur kampionatet, por me dyer të mbyllura. Futbollit pa spektatorë nuk është i bukur, por e bëjmë për të mirën e futbollistëve. Po e mbyllim kampionatin me shpresën që të bëjmë edhe disa ndeshje me tifozë në stadiume. Megjithatë, tani që ka disa raste të reja me Covid-19, synojmë ta mbyllim sezonin. I kemi rihapur të gjitha kategoritë.

Çfarë mund të thoni për Kumbullën?

Një mbrojtës i mirë, luan në kombëtare dhe përfaqëson të ardhmen tonë.

Flitet se mund të shkojë tek Interi. Sipas jush, a është djaloshi gati për këtë hap të madh?

Është akoma i ri, vetëm 20 vjeç, nuk e di nëse në një skuadër të madhe do të ishte menjëherë titullar, por me siguri mund të rritet edhe më shumë. Këtë vit te Verona ka treguar një personalitet të madh dhe të bën të mendosh



që mund të shndërrohet në një "top-player". Di që interesohet edhe Juventus. Ka qenë edhe Napoli në janar. Për ne është e rëndësishme që ai të luajë gjithmonë për 90 minuta, kudo ku ai zgjedh të luajë, kështu mund të jetë edhe në formë edhe për Kombëtaren.

Tani është një sfidë mes Juventusit dhe Lazios. Ju shqiptarët, gjithashtu, keni përfaqësues edhe në Romë...

Drejtori është i yni. Edhe portieri Strakosha. Prej disa vitesh Lazio po luan mjaft mirë dhe në këtë kampionat po bën diçka të mrekullueshme: mund të luajë shanset e veta deri në fund. Nuk e di se në çfarë forme do të jenë pas ndërprerjes, por para fillimit të pandemisë ishin në formë të shkëlqyer. Shpresojmë të jenë mirë dhe Strakosha të mos pësojë asnjë gol.

Çfarë mendoni për Igli Tarën?

Mendoj se ai është i aftë ta arrijë

suksesin në Itali dhe në Evropë: ka gjetur lojtarë të mirë, duke ndërtuar një skuadër të aftë për të marrë rezultate të mira. Madje edhe ekonomikisht ka bërë punë shumë të mirë: është e gjitha meritë e tij.

Ju e doni Italinë. Çfarë mund të na thoni për trajnerin Reja?

Edi është një trajner i madh, ka përvojë dhe shumë ndeshje në karrierë. Kemi shumë shpresa, që me të në stol të kualifikohemi në një turne madhor, duke përsëritur atë çfarë ka bërë heroi ynë De Biasi, të cilin e do i gjithë populli shqiptar.

Si ndryshon kalendari i Kombëtares shqiptare?

Mbetet thuajse i njëjti, në shtator do të kemi dy sfida të Nations League dhe pastaj tre në tetor, dy të Nations League dhe një miqësore për ne që nuk jemi në "play-off". Të organizosh miqësore para kësaj date është e pamundur, pasi nuk gjen data.

SHKURT

Bach: Olimpiada zhvillohet vitin tjetër ose anulohet

Lojërat Olimpikë "Tokio 2020", të parashikuara për t'u zhvilluar këtë vit, janë shtyrë për vitin tjetër për shkak të koronavirusit. IOC dhe organizatorët e Olimpiadës kanë vendosur prej kohësh që ky event të zhvillohet më 23 korrik-8 gusht të vitit 2021. Presidenti i IOC (Komitetit Olimpik Ndërkombëtar), Thomas Bach, ka deklaruar se në rast se kjo olimpiadë nuk zhvillohet as vitin tjetër, atëherë ajo do të anulohet. Kohët e fundit janë shtuar zërat se olimpiada japoneze është në rrezik. "Na vjen keq që u shty, por u bë për të mirën e të gjithëve. Ne urojmë që ajo të zhvillohet pas një viti, duke shpresuar që situata të jetë përmirësuar. Në rast se do të shtyhet sërish, atëherë është më mirë të mos zhvillohet fare", ka thënë Bach.

Guardiola: Sane dëshiron të largohet nga City

Trajneri i Manchester Cityt, Pep Guardiola, ka konfirmuar se Leroy Sane nuk dëshiron ta vazhdojë kontratën me Cityn. Anëtori spanjoll do të largohet nga 'Etihad Stadium' nëse Manchester City merr një ofertë të pëlqyeshme, në të kundërtën, ai do të presë deri në vitin e ardhshëm për t'u larguar falas. "Kur ne bëjmë një ofertë të një lojtar është sepse e duam atë", ka deklaruar Guardiola teksa fliste për situatën e Sane. "Ai ka kualitete speciale. Ne duam që lojtarët të luajnë për këtë klub dhe t'i arrijnë synimet. Ai është një djalë i mirë dhe unë e dua atë shumë. Nuk kam asgjë kundër tij, por ai dëshiron një tjetër aventurë. Leroy ka refuzuar vazhdimin e kontratës. Të gjithë e dinë. Nëse në fund të sezonit, të dy klubet arrijnë marrëveshje, ai mund të largohet, nëse jo, ai largohet në fund të kontratës", ka deklaruar Guardiola. E ardhmja e Lorey Sane është në Bundesligë, ku ai po kërkohet nga Bayern Muncheni.

Fiorentina ëndërron transferimin e Silvës

Pas francezit Franck Ribery, Fiorentina ëndërron një tjetër goditje të madhe me parametër zero. Sipas "Sky Sport", objektivi i klubit vjollcë ka përfunduar Thiago Silva, i cili do të largohet nga PSG sapo të mbyllet sezoni.

Qendërbrojtësi brazilian është ndjekur edhe nga Milani e Evertoni, por në garë është përfshirë edhe skuadra toskane e presidentit Comisso, i cili dëshiron ta përforcojë organikën me një element me shumë përvojë. Kjo hipotezë ka marrë jetë ditët e fundit, pas kontakteve të para me përfaqësuesit e futbollistit, që dëshiron të luajë ende në Evropë në nivele të larta. 35-vjeçari është i interesuar për ta dëgjuar ofertën e Fiorentinës, për të zgjedhur më pas atë që i përshtatet më shumë.

La Liga kërkon t'i rikthejë tifozët në fund të sezonit

Pasi rinisi sezonin e ndërprerë për shkak të pandemisë së Covid-19, La Liga kërkon t'i kthejë tifozët për ndeshjet e fundit të kampionatit. Rruga është ende e gjatë deri te vendimi që do të merret nga autoritetet sanitare dhe qeveritare spanjolle, por drejtuesit e Ligës kanë avancuar me projektin e tyre për t'i hapur dyert e stadiumeve. Konfirmimi për këtë vjen nga presidenti Javier Tebas. Në një intervistë për të përditshmen iberike "AS", ai ka rrëfyer detaje të këtij plani, që kërkon ndryshimin e protokollit për rikthimin në fushë të futbollit spanjoll. "Po punojmë mbi mundësinë e rihapjes së stadiumeve, por duhen garantuar distancimi social dhe mbajtja e maskave. Po studiojmë një mënyrë të re për hyrjen e tifozëve në tribuna. Çdo tifoz me anë të internetit duhet ta njoftojë orën dhe minutën e saktë të hyrjes në stadium", është shprehur Tebas. Liga 1 dhe 2 u kthyen në fushë më 11 qershor, ndërsa deri tani janë luajtur dy javë të kampionatit.

Todt: Lutem çdo ditë për Schumacherin

BERLIN, 19 QERSHOR - Pavarësisht se Michael Schumacheri u largua nga Ferrari në vitin 2006 dhe më pas u rikthye te Mercedesi në vitin 2010, presidenti aktual i FIA, Jean Todt, ka mbetur shumë i lidhur me pilotin gjerman. Ai mbetet një nga personat e paktë që ka informacion për gjendjen e tij shëndetësore, një dyshe që shkroi historinë e Formulës 1. "Në vitet 1997 dhe 1998 humbëm titullin në garën e fundit. Edhe në vitin 1999 por, të paktën, fituam atë për konstruktorë. Më pas erdhën vitet më të bukura. Nëse nuk ia dolëm dot më parë të fitonim, kjo ndodhi pasi nuk kishim një harmoni brenda skuadrës", ka deklaruar Todt.



Duke folur për gjendjen aktuale shëndetësore të pilotit gjerman, Todt ka shtuar: "Unë lutem gjithnjë për Michaelin. Kur shoh Hamiltonin që i afrohet rekordit

të shtatë titujve më zgjohen gjithnjë kujtimet e asaj periudhe. Por rekordet janë bërë për t'u thyer dhe kohët sot janë ndryshe nga ajo e Schumacherit".



Ndërmarrja Publike Lokale "Prishtina Parking" Sh.A. Prishtinë



Në bazë të dispozitave të Nenit 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, si dhe Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Ndërmarrja Publike Lokale "Prishtina Parking" Sh.A. Prishtinë, shpall:

KONKURS

Për pozitat:

I. *Shef/e i/e Kabinetit, një (1) pozitë*

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Të ushtrijë detyrën e shefit të kabinetit dhe të shërbejë si ndihmës i lartë i KE-së;
- Të menaxhojë procesin e punës në zyrën e KE-së lidhur me përgatitjen, lëshimin dhe komunikimin e vendimeve, udhëzimeve dhe urdhërësive KE-së dhe të kujdeset për sigurimin e respektimit të tyre;
- Të ketë nën kontroll njoftimet substanciale të punës së KE-së dhe që të jetë në mundësi të menaxhojë, në emër të KE-së një numër të madh të çështjeve të ndërlikuara që dalin nga ushtrimi i detyrave që janë në mandatin e KE-së;
- Të bëjë adresimin e saktë në marrjen dhe ofrimin e përgjigjeve për të gjitha fushat e veprimit të njësive organizative të Ndërmarrjes në raport me Zyrën e KE-së;
- Të jap njoftime (të informojë) përmbajtësore rreth politikave dhe proceseve administrative, dhe të menaxhojë një sërë çështjesh të ndërlikuara për KE-së;
- Të organizojë punën dhe menaxhimin efikas të aktiviteteve të përditshme të zyrës së KE-së dhe ndërldhjen e drejtorive, departamenteve dhe njësive tjera organizative të ndërmarrjes me zyrën e KE-së;
- Harton shkresa, vendime, udhëzime dhe akte tjera për Zyrën e KE-së;
- Bashkëpunon me udhëheqësit e drejtorive, departamenteve, dhe njësive tjera të ndërmarrjes sipas udhëzimeve të KE-së lidhur me koordinimin për realizimin e aktiviteteve të tyre;
- Përgatit raporte periodike mbi aktivitetet organizative dhe çështjeve që kërkojnë shqyrtim nga KE-ja;
- Siguron klasifikimin, mirëmbajtjen dhe ruajtjen e akteve dhe dokumenteve në Zyrën e KE-së;
- Merr pjesë në mbledhjet e ndryshme të KE-së, mban shënime dhe harton procesverbale sipas nevojës;
- Ofron këshilla profesionale dhe ndihmon realizimin e agjendës së punës për KE-në në zhvillimin dhe arritjen e objektivave të punës.

Kualifikimi dhe përgatitja profesionale:

- Kandidati duhet të ketë diplomë në fushën e: Ekonomisë dhe Menaxhmentit. Preferohet edukim i avancuar (Master) në sektorin e Ndërmarrjes dhe/apo Inovacionit;
- Trajnimet për zhvillim dhe avancim akademik në fushën e Ekonomisë, Menaxhmentit, Administrim Biznesi etj., përbëjnë avantazh konkurrues;
- Të ketë së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale, përfshirë së paku tre (3) vite në pozitë drejtuese/menaxhuese dhe eksperiencë në Menaxhim të Projekteve;
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze në të shkruar dhe të folur;
- Të ketë njohuri të duhura për menaxhimin strategjik të ndërmarrjeve;
- Të jetë në gjendje të ofroj alternativë për arritjen e rezultateve afariste pozitive të ndërmarrjes dhe të ndihmojë në menaxhim të ndryshimeve për arritjen e rezultateve pozitive komform vendimeve të bordit të drejtorëve dhe ligjeve aktuale në fuqi;
- Të ketë aftësi për të kuptuar dhe interpretuar të dhënat financiare për vendimarrje;
- Shkathësi të lartë në menaxhim, organizim, caktim të objektivave dhe planifikim;
- Njohuri të mira për mbikëqyrje efektive të punës profesionale të kryer nga vartësit;
- Shkathësi të nivelit të lartë në komunikim dhe negociim;
- Zotësi për t'u përshtatur në situata të pa-planifikuara;
- Qasje fleksibile ndaj organizimit dhe mbikëqyrjes së punës, përfshirë zgjidhjen e problemeve;
- Shkathësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Microsoft Project);
- Të jetë i/e pavarur dhe të ketë nivel të lartë të integritetit përgjatë aktiviteteve në ndërmarrje;
- Të ketë aftësi për të krijuar raporte të mira pune dhe raporte ndër personale.

Procedura e Konkurrimit

Kandidati-ja për pozitën **Shef/e i/e Kabinetit** duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- Aplikacionin;
- CV-në;
- Dëshminë e Shkollimit kopje të noterizuar;
- Dëshminë për Përvojën e Punës (Trusti pensional);
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj);
- Vërtetimin tatimor nga ATK-ja;
- Kopjen e Lejes së Njoftimit dhe Ekstraktin e Lindjes;
- Referenca të tjera që janë të rëndësishme për këtë vend pune;
- Letër motivimin;
- Deklarata nën betim.

II. *Zyrtar/e për zhvillim të biznesit, një (1) pozitë*

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Është përgjegjës për punën në lëshimin e marrëveshjeve (kontratave), bën verifikimin e dokumentacioni të nevojshëm për vendparkimet;
- Mban evidenca për çdo marrëveshje (kontratë) për vendparkim;
- Është përgjegjës për menaxhimin e vendparkimeve individuale;
- Është përgjegjës për zbatimin e rregullave dhe urdhërësive të Kryeshefit Ekzekutiv.

Detyrat dhe obligimet tjera shtesë:

- Kryeshefi Ekzekutiv mund ta ngarkojë me detyra tjera sipas rasteve emergjente të ndërmarrjes;
- Në rast të mungesës së zyrtarëve tjerë me urdhëresë të Kryeshefit Ekzekutiv mund t'i zëvendësojë dhe ti kryen detyrat tjera;
- Kryen edhe detyra tjera që lidhen me përshkrimin e detyrave të punës, si dhe detyrave të ngarkuara nga Kryeshefi Ekzekutiv.

Kualifikimi dhe përgatitja profesionale:

- Shkollimi Universitar (Ekonomik, preferuese);
- Së paku një (1) vit përvojë pune;
- Kurse dhe trajnime tjera gjatë karrierës profesionale;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe negociimi;
- Të ketë njohuri të mira të gjuhëve të huaja në të shkruar dhe të folur;
- Shkathësi kompjuterike (Microsoft Office);
- Patentë Shofer kategoria B.

Procedura e Konkurrimit

Kandidati-ja për pozitën **Zyrtar për Zhvillimin e Biznesit** duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- Aplikacionin;
- CV-në;
- Dëshminë e Shkollimit kopje e noterizuar;
- Dëshminë për Përvojën e Punës (Trusti pensional);
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj);
- Vërtetimin tatimor nga ATK-ja;
- Kopjen e Lejes së Njoftimit dhe Ekstraktin e Lindjes;
- Referenca të tjera që janë të rëndësishme për këtë vend pune;
- Letër motivimin;
- Deklarata nën betim.

III. *Shofer/e, një (1) pozitë*

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Zbaton udhëzimin për përdorimin e automjeteve të Ndërmarrjes;
- Zbaton porosinë për bartjen e personave zyrtarë të ndërmarrjes për udhëtime zyrtare në destinime të caktuara dhe anasjelltas;
- Është përgjegjës për mirëmbajtjen e përditshme të automjetit të caktuar;
- Kujdeset për pajisjet speciale të automjetit, ose të ndonjë automjeti tjetër të ndërmarrjes;
- Bën kontrollimin e vajit ujit baterisë dhe gomave të automjetit;
- Me rregull lajmëron zyrtarin e logjistikës për dërgimin e automjetit në servisim;
- Punon dhe bashkëpunon me anëtarët e tjerë të personelit kur ka mundësi, sipas kërkesës së mbikëqyrësit.

Kualifikimi dhe përgatitja profesionale

- Diploma e Shkollës së Mesme;
- Të ketë së paku një (1) vit përvojë në pozitë e ngjashme si Shofer;
- Të ketë patentë shofer valid për ngasje (kategoria "B" e detyrueshme);
- Të ketë aftësi që të punoj me të tjerët në mjedis multietnik;
- Të jetë punëtor i zellshëm, i mësuar të punojë në terren;
- Të ketë njohuri të regjioneve dhe rrugëve të Prishtinës (Kosovës).

Procedura e Konkurrimit

Kandidati-ja për pozitën **Shofer/e** duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- Aplikacionin;
- CV-në;
- Dëshminë e Shkollimit kopje të noterizuar;
- Dëshminë për Përvojën e Punës (Trusti pensional);
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj);
- Vërtetimin tatimor nga ATK-ja;
- Kopjen e Lejes së Njoftimit dhe Ekstraktin e Lindjes;
- Referenca të tjera që janë të rëndësishme për këtë vend pune;
- Letër motivimin;
- Deklarata nën betim.

IV. *Zyrtar/e për Financa, një (1) pozitë*

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përgatitë pasqyrat financiare mujore dhe raporte të ndryshme duke mbledhur dhe analizuar informatat e kontabilitetit ;
- Pranon, regjistron dhe mirëmban faturat dhe dokumentet burimore në dosje, dhe sigurohet që ato janë të plota;
- Të njoh mirë programet financiare dhe t'i paraqesë në kohë dhe me saktësi llogaritë e inventarit, klientëve, furnitorëve, etj;
- Ka përgjegjësi të ndërtojë një sistem raportimi financiar sipas kërkesave të Kryeshefit Ekzekutivë;
- Administron procedurat financiare dhe garanton saktësinë e regjistrimit të veprimeve financiare;
- Kujdeset për aplikimin e rregullit të ligjit mbi kontabilitetin , rregullave ekonomike –financiare;
- Të përgatis të dhënat e kompanisë për auditim në fund të vitit si dhe çfarëdo tjetër detyrë të përcaktuar nga Kryeshefi Ekzekutivë.

Detyrat dhe obligimet tjera shtesë:

- Kryeshefi Ekzekutiv mund ta ngarkojë me detyra tjera sipas rasteve emergjente të ndërmarrjes;
- Në rast të mungesës së zyrtarëve tjerë me urdhëresë të Kryeshefit Ekzekutiv mund t'i zëvendësojë dhe ti kryen detyrat tjera;
- Kryen edhe detyra tjera që lidhen me përshkrimin e detyrave të punës, si dhe detyrave të ngarkuara nga Kryeshefi Ekzekutiv.

Kualifikimi dhe përgatitja profesionale:

- Shkollimi Universitar (Ekonomik);
- Së paku katër (4) vite përvojë pune;
- Kurse dhe trajnime tjera gjatë karrierës profesionale (SCAAK);
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe negocimi;
- Të ketë njohuri të mira të gjuhëve të huaja në të shkruar dhe të folur;
- Shkathësi kompjuterike (Microsoft Office);
- Patentë Shoferi kategoria B.

Procedura e Konkurrimit

Kandidati-ja për pozitën **Zyrtar/e për Financa** duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- Aplikacionin;
- CV-në;
- Dëshminë e Shkollimit kopje të noterizuar
- Dëshminë për Përvojën e Punës (Trusti Pensional);
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj);
- Vërtetimin tatimor nga ATK-ja;
- Kopjen e Lejes së Njofimit dhe Ekstraktin e Lindjes;
- Referenca të tjera që janë të rëndësishme për këtë vend pune;
- Letër motivimin;
- Deklarata nën betim.

V. Menaxher/e për Resurse Njerëzore, një (1) pozitë**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Drejton procedurat bazë të RNJ të ndërmarrjes për administrimin e punonjësve, rekrutimin, trajnimin dhe zhvillimin e karrierës.
- Drejton politikën e RNJ duke zbatuar, interpretuar, monitoruar aplikimin e tyre dhe komunikon me Menaxheret e Departamenteve apo me Zyrat Qendrore me qëllim zbatimin e politikave në mënyrën e duhur.
- Ndërton, zhvillon dhe monitoron buxhetin dhe burimet e tjera që i janë caktuar Departamentit të RNJ.
- Harton, drejton dhe ndjek zbatimin e planin të rekrutimit.
- Ndjek procesin e nënshkrimit të kontratave individuale të punës për punonjësit si dhe zbatimin e procedurave të brendshme të ndërmarrjes në përputhje me Kodin e Punës dhe ligje të tjera të zbatueshme.
- Përpilon, ndjek dhe sigurohet që administrimi i dosjeve të personelit të jetë i plotë dhe në cilësi duke monitoruar plotësimin me të gjitha dokumentet e kërkuara.
- Ndjek procesin me plotësimin me mjete/pajisje të punës të nevojshme për çdo punonjës në ndërmarrje që të përdorë në pozicionin e tij të punës.
- Përgatit borderonë e punonjësve dhe listpagesën e sigurimeve shoqërore e shëndetësore. Mban marrëdhëniet me organet tatimore dhe zyrën e punës duke respektuar legjislacionin, kodin e punës etj.;
- Përcakton së bashku me Menaxherët e Departamenteve dhe administron nevojat për trajnim për punonjësit e ndërmarrjes;
- Ndjek Panairët e Punësimit me qëllim tërheqjen e talenteve dhe praktikave të vlefshme për ndërmarrjen;
- Mban në mënyrë të vazhdueshme komunikimin me drejtuesit e departamenteve me qëllim përmirësimit të klimës së punës dhe garantimin e performancës së punonjësve të ndërmarrjes;
- Mbledh, monitoron, përpunon dhe administron informacionin në lidhje me shpenzimet e personelit.

Kualifikimi dhe përgatitja profesionale:

- Shkollimi Universitar Juridik, Ekonomik (Administrim Biznesi ose Shkenca Sociale);
- Së paku tre (3) vite përvojë pune;
- Kurse dhe trajnime tjera gjatë karrierës profesionale;
- Njohuri të avancuara në legjislacionin në fuqi;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe negocimi;
- Të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze në të shkruar dhe të folur;
- Shkathësi kompjuterike (Microsoft Office);
- Patentë Shoferi kategoria B.

Procedura e Konkurrimit

Kandidati-ja për pozitën **Menaxher/e për Resurse Njerëzore** duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- Aplikacionin;
- CV-në;
- Dëshminë e Shkollimit kopje të noterizuar
- Dëshminë për Përvojën e Punës (Trusti pensional);
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj);
- Vërtetimin tatimor nga ATK-ja;
- Kopjen e Lejes së Njofimit dhe Ekstraktin e Lindjes;
- Referenca të tjera që janë të rëndësishme për këtë vend pune;
- Letër motivimin;
- Deklarata nën betim.

VI. Zyrtar/e Kontabiliteti, një (1) pozitë**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Regjistrimet kontabël të transaksioneve të biznesit;
- Lëshimi dhe regjistrimi i faturave të shitjes dhe të gjitha dokumenteve tjera dalëse;
- Mbajta e librave të shitje dhe blerjes;
- Ofron informata relevante dhe me kohe sipas kërkesave të Menaxhmentit të ndërmarrjes;
- Koordinon dhe është përgjegjës për regjistrimin e të gjitha dokumentacionit në divizionin e kontabilitetit;
- Bën regjistrimin kontabël të hyrave dhe shpenzimeve, dhe urdhëresave tjera në softuerin e kontabilitetit;
- Bën përcjelljen dhe barazimin e llogarive të arketueshme dhe pagueshme dhe përpilon raportet përcjellëse në baza të ndryshme periodike sipas kërkesës;
- Mban dhe është përgjegjës për sistemin e kontabilitetit sipas legjislacionit tatimor dhe parimeve të kontabilitetit;
- Bën arkivimin dhe sistemin e dokumenteve financiare në kuadër të sektorit të kontabilitetit;
- Kryen dhe detyra tjera të përcaktuara nga Kryeshefi Ekzekutiv.

Kualifikimi dhe përgatitja profesionale:

- Shkollimi Universitar (Ekonomik);
- Së paku tre (3) vite përvojë pune;
- Kurse dhe trajnime tjera gjatë karrierës profesionale;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe negocimi;
- Të ketë njohuri të mira të gjuhëve të huaja në të shkruar dhe të folur;
- Shkathësi kompjuterike (Microsoft Office);
- Patentë Shoferi kategoria B.

Procedura e Konkurrimit

Kandidati-ja për pozitën **Zyrtar/e Kontabiliteti** duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- Aplikacionin;
- CV-në;
- Dëshminë e Shkollimit kopje të noterizuar
- Dëshminë për Përvojën e Punës (Trusti pensional);
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj);
- Vërtetimin tatimor nga ATK-ja;
- Kopjen e Lejes së Njofimit dhe Ekstraktin e Lindjes;
- Referenca të tjera që janë të rëndësishme për këtë vend pune;
- Letër motivimin;
- Deklarata nën betim.

VII. Arkëtar/e, një (1) pozitë**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Menaxhon dhe mirëmban të gjitha transaksionet e parasë së gatshme në ndërmarrje;
- Kujdeset për sigurinë e të gjitha parave të gatshme në Ndërmarrje;
- Planifikon dhe kontrollon të gjitha shpenzimet e parasë së gatshme;
- Mban evidencën për shpenzimet e parasë së gatshme dhe sistemon në regjistratorin përkatës;
- Rishikon raportet, format, dhe të dhënat për saktësinë, plotësin, dhe përputhshmërinë në mënyrë të arsyeshme kohe pas kohe nga mbikëqyrësi;
- Pranon advance dhe përkujdeset për mbylljen e avancave.

Detyrat dhe obligimet tjera shtesë:

- Kryeshefi Ekzekutiv mund ta ngarkojë me detyra tjera sipas rasteve emergjente të ndërmarrjes;
- Në rast të mungesës së zyrtarëve tjerë me urdhëresë të Kryeshefit Ekzekutiv mund t'i zëvendësojë dhe t'i kryen detyrat tjera;
- Kryen edhe detyra tjera që lidhen me përshkrimin e detyrave të punës, si dhe detyrave të ngarkuara nga Kryeshefi Ekzekutiv.
- Shkollimi Universitar (Ekonomik);
- Së paku dy (2) vite përvojë pune;
- Kurse dhe trajnime tjera gjatë karrierës profesionale;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe negocimi;
- Të ketë njohuri të mira të gjuhëve të huaja në të shkruar dhe të folur;
- Shkathësi kompjuterike (Microsoft Office);
- Patentë Shoferi kategoria B.

Procedura e Konkurrimit

Kandidati-ja për pozitën **Arkëtar/e** duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- Aplikacionin;
- CV-në;
- Dëshminë e Shkollimit kopje të noterizuar;
- Dëshminë për Përvojën e Punës (Trusti pensional);
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj);
- Vërtetimin tatimor nga ATK-ja;
- Kopjen e Lejes së Njofimit dhe Ekstraktin e Lindjes;
- Referenca të tjera që janë të rëndësishme për këtë vend pune;
- Letër motivimin;
- Deklarata nën betim.

VIII. Dispeçer/e, një (1) pozitë**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Mbikëqyrja dhe puna me personelin i cili punon në teren;
- Evidentimi i punës jo të rregullt në teren, evidentimi i punës jo të rregullt të sistemit dhe mënjanimi i gabimeve;
- Mirëmbajtja e kompjuterëve portativ (verifikimi i korrektesisë së punës të kompjuterëve portativ dhe pajisjeve tjera);
- Përgatitja e kompjuterëve portativ dhe pajisjeve përcjellëse për punë në terren (mbushja e baterive, rregullimi i parametrave të pajisjeve dhe printerëve);
- Dhënie e pajisjeve për punën e kontrollorëve (kompjuterin portativ PocketPC dhe printerin portativ) në fillim të ndërrimit dhe pranimit në fund të ndërrimit.

Kualifikimi dhe përgatitja profesionale:

- Shkollimi Universitar (Ekonomik, preferuese);
- Së paku tre (3) vite përvojë pune;
- Kurse dhe trajnime tjera gjatë karrierës profesionale;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe negocimi;
- Të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze në të shkruar dhe të folur;
- Shkathësi kompjuterike (Microsoft Office);
- Patentë Shoferi kategoria B.

Procedura e Konkurrimit

Kandidati-ja për pozitën **Dispeçer/e** duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- Aplikacionin;
- CV-në;
- Dëshminë e Shkollimit;
- Dëshminë për Përvojën e Punës (Trusti pensional);
